

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5797
E hënë, 10 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Në Gjykatën e Apelit
janë vetëm dy gjyqtarë
që merren me çështje
ekonomike | FAQE 8-9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**SHOKËT
QË (NUK) E
DUAN ADEM
JASHARIN** F. 11

Shkruan: Sabit
ISTOGU



AKTUALE

**META SHFUQIZON
DEKRETIN PËR ZGJEDHJET
E 30 QERSHORIT, RAMA
KUNDËRSHTON** F. 2

**THAÇI: NËSE NUK
NDRYSHON SISTEMI
ZGJEDHOR, LARGHEM
PËRGJITHMONË
NGA POLITIKA** F. 5

**ÇDO VIT KOMISIONI
EVROPIAN PËRSËRIT
REKOMANDIMET
E NJËJTA PËR KOSOVËN** F. 7

EKONOMI

**SIVJET KOSOVA PRET
RENDIMENTE TË ULËTA
TË GRURIT** F. 9

KULTURË

**NË SUNDERN TË GJERMANISË
U PROMOVUA 'LIBRI I LUFTËS'**

F. 13

SPORT

NDEROHET LEGJENDA F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", IMRI AHMETI | FAQE 4-5

Në shtator parashihet rrëzimi i qeverisë

Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Imri Ahmeti, e ka quajtur serioze iniciativën e kësaj partie dhe të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për ta larguar nga pushteti koalicionin PAN. Ai ka thënë se kjo iniciativë do të ketë sukses dhe, sipas tij, në shtator

synohet rrëzimi i qeverisë dhe mbajtja e zgjedhjeve të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se opozita nuk llogarit në votat e deputetëve serbë për rrëzimin e qeverisë, por në votat që mund të vijnë nga koalicioni qeverisës. Ahmeti ka

folur edhe për procesin zgjedhor brenda LDK-së, me ç'rast ka thënë se rrahjet nëpër disa degë nuk do të sjellin pakënaqësi të mëdha apo ndarje të partisë. Sipas tij, arsyeja e situatave të tensionuara nëpër këto degë është tendenca për ta ruajtur postin me çdo kusht

Veseli kërkon komision hetimor për listat e veteranëve të UÇK-së

Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka kërkuar të dielën komision hetimor parlamentar për listat e veteranëve të UÇK-së. Ai ka treguar se javën e ardhshme grupi parlamentar i PDK-së do ta iniciojë krijimin e këtij komisioni i cili do t'i hetojë e pastrojë listat e veteranëve të UÇK-së. I pari i PDK-së për abuzime me këto lista ka drejtuar gishtin edhe kah ish-epororët e lartë të UÇK-së. Sipas Veselit, krahas komisionit, do të iniciohen edhe ndryshimet e duhura në Ligjin për Veteranët e Luftës së UÇK-së | FAQE 3



**Kosova, shembull
unik për tolerancën
dhe bashkëjetesën
ndërfetare** | FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pendarovski propozon model të ri zgjedhor në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 9 QERSHOR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka kërkuar nga partitë politike që të diskutojnë mundësinë e ndryshimit të Kodit Zgjedhor në sistem proporcional me më pak njësi zgjedhore dhe me lista të hapura, si dhe pa prag zgjedhor apo me një prag minimal të votave të nevojshme, në funksion të zgjerimit të përfaqësimit politik në Kuvend. "Një model i ri zgjedhor do t'u mundësonte qytetarëve që të zgjedhin jo vetëm parti politike, por edhe kandidatët. Zhvillimi demokratik, sundimi i së drejtës dhe zgjedhjet e lira dhe demokratike janë

faktor i rëndësishëm i prosperitetit të vendit tonë", thuhet në një njoftim nga kabineti i presidentit. Nga Lidhja Social Demokrate e kryeministrit Zoran Zaev e kanë mirëpritur një propozim të tillë, duke theksuar se kjo është edhe pjesë e programit të saj politik. "Për një propozim të ngjashëm kemi folur para zgjedhjeve të vitit 2016 kur ishim në opozitë. Kjo është pjesë e programit tonë zgjedhor. Parimi i një njësie zgjedhore e forcon votën e qytetarëve, sikur edhe propozimi për lista të hapura", ka deklaruar Lupco Nikollovski, sekretar i përgjithshëm i LSDM-së.

VMRO-DPMNE-ja e opozitës ka thënë se qëndrimin e saj do të bëjë të ditur pasi të ketë një propozim konkret në Kuvend. Nga partitë shqiptare, Bashkimi Demokratik për Integrim ka thënë se me rëndësi për të është mbarëvajtja e zgjedhjeve dhe se do të pranonte cilindo model zgjedhor. Opozita ndërkohë mbështet lista e hapura, por me të paktën tri njësi zgjedhore. Maqedonia e Veriut aktualisht ka sistem zgjedhor proporcional me gjashtë njësi zgjedhore dhe me lista të mbyllura. Kuvendi numëron 120 deputetë dhe nga çdo njëri njësi zgjidhen nga 20 deputetë. Debatimi për ndryshimet



në Kodin Zgjedhor vjen një ditë pas kryeministrit, Zoran Zaev nuk e përjashtoi mundësinë e rënies së Qeverisë dhe zgjedhjeve të

parakohshme, nëse Maqedonia e Veriut nuk merr datën nga Bashkimi Evropian për nisjen e bisedimeve për anëtarësim.

Meta shfuqizon dekretin për zgjedhjet e 30 qershorit, Rama kundërshton

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka bërë me dije anulimin e dekretit me anë të të cilit ai kishte shpallur 30 qershorin si datë të zgjedhjeve, ndërkaq kryeministri Edi Rama, nga vizita e tij në qytetin e Beratit, ka kundërshtuar vendimin e presidentit, duke thënë se zgjedhjet do të mbahen pikërisht më 30 qershor



TIRANË, 9 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka shfuqizuar dekretin për zhvillimin e zgjedhjeve lokale që ishin planifikuar të mbaheshin më 30 qershor. Njoftimi për media nga Presidenca e Shqipërisë u bë pak kohë para nisjes zyrtare të protestës së opozitës.

Presidenti Meta ka bërë të ditur vetëm anulimin e dekretit me anë të të cilit ai kishte shpallur 30 qershorin si datën e zgjedhjeve, duke shtuar që në ditët në vazhdim "do t'i bëjë publikisht me dije të gjithë argumentet shteruese kushtetues, ligjorë dhe logjike që çuan në marrjen e këtij vendimi".

Në deklaratën e tij, presidenti Meta ka shpjeguar arsyet e vendimit të tij, duke thënë se ky vendimi ka ardhur si pasojë e "shqetësimit të thellë për situ-

atën kritike të krijuar në vend si pasojë e mos-reflektimit të asnjërës palë". "Duke ftuar të gjithë aktorët e përgjegjshëm vendas dhe ndërkombëtarë të bashkojnë kontributet konstruktive për rivendosjen urgjent të dialogut të pazëvendësueshëm politik dhe për gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë dhe që i shërben të ardhmes evropiane të Shqipërisë, kam vendosur të shfuqizoj Dekretin nr. 10928, datë 05.11.2018 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore më datë 30 qershor 2019", ka shkruar presidenti.

Meta ka thënë se "kushtet aktuale nuk mundësojnë zhvillimin e zgjedhjeve të vërteta, demokratike, përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë kriter

kryesor i Kopenhagës dhe në kushtet aktuale, për mungesë përgjegjësie të të dy palëve, po shkojmë drejt votimeve një partiake. Në këtë mënyrë minohet çdo mundësi për çeljen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, dëmtohet imazhi si vend anëtar i NATO-s

dhe cenohet kryesimi i OSBE-në për vitin 2020".

Kryeministri Edi Rama, nga vizita e tij në qytetin e Beratit, ka kundërshtuar vendimin e presidentit, duke thënë se zgjedhjet do të mbahen pikërisht më 30 qershor. Vendimi i presidentit të Shqipërisë vjen

pasi vendi ndodhet në një krizë të thellë politike, ku dy partitë opozitare dhe aleatët e tyre të djathtë kanë djegur mandatet në Kuvend dhe kanë vendosur të mos marrin pjesë në zgjedhjet lokale dhe kanë thënë se nuk do të lejojnë mbajtjen e tyre.

Basha: Largimi i Ramës është i panegociueshëm

TIRANË, 9 QERSHOR - Pas anulimit të zgjedhjeve të 30 qershorit nga presidenti Ilir Meta, kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, tha se tani është koha që të luftojmë dhe se largimi i Edi Ramës është i panegociueshëm.

Nëpërmjet një postimi në Facebook, shefi i selisë blu shkruan se beteja do të vazhdojë. "Boll

më me Shqipërinë që duan ata, tani është koha të luftojmë për Shqipërinë e të gjithë shqiptarëve! Ora e Shqipërisë si e gjithë Evropa po troket dhe nuk ka forcë ta ndalë! Falë vendosmërisë tuaj të pathyeshme, falë bashkimit të zemrave dhe mendjeve të shqiptarëve të lirë, zgjedhjet farsë të 30 qershorit u anuluan!

Beteja jonë do të vazhdojë deri në triumfin e standardeve dhe vlerave evropiane. Pengesa e vetme për në Evropë është sundimi i shtetit të bërë njësh me krimin, është qeveria e ardhur me votën e krimin, është kryeministri i Avdylajve. Largimi i Ramës është i panegociueshëm", ka shkruar Basha.



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka mbajtur të dielën konferencë për medie

Veseli kërkon komision hetimor për listat e veteranëve të UÇK-së

Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka kërkuar të dielën KOMISION hetimor parlamentar për listat e veteranëve të UÇK-së. Ai ka treguar se javën e ardhshme grupi parlamentar i PDK-së do ta iniciojë krijimin e këtij komisioni i cili do t'i hetojë e pastrojë listat e veteranëve të UÇK-së. I pari i PDK-së për abuzime me këto lista ka drejtuar gishtin kah ish-eprorët e lartë të UÇK-së. Sipas Veselit, krahas komisionit, do të iniciohen edhe ndryshimet e duhura në Ligjin për Veteranët e Luftës së UÇK-së



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 QERSHOR- Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka paralajmëruar se javën e ardhshme kjo parti do ta iniciojë komision hetimor parlamentar, i cili do t'i hetojë e pastrojë listat e veteranëve të UÇK-së. Të dielën në një konferencë për medie, ai ka treguar se do të ndërmerret kjo iniciativë në mënyrë që të ndalet fryrja e listave nga komandantë e veteranë mashtrues.

Ai ka deklaruar se kësaj nisme do t'i shkohet deri në fund, për ta pastruar emrin e vërtetë të UÇK-së nga personat mashtrues. "Javën që vjen PDK-ja do të nisë një tjetër iniciativë legjitime në vazhdim e adresimeve të shqetësimeve publike: statuset e veteranëve të luftës, për të cilat ka dyshime se janë ndarë pa merita. Shumica e komandantëve të luftës kanë folur dhe kanë shprehur shqetësimet e tyre serioze për këtë çështje. Sot jam këtu për ta ruajtur emrin dhe reputacionin e vërtetë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Njolllosja e emrit të UÇK-së, e luftëtarëve të lirisë, shpesh për shkak të disave që synojnë përfitimet personale, na ka lënduar të gjithëve", ka thënë Veseli. Kreu i PDK-së ka deklaruar se me këto veprime jo rrallë janë fyer luftëtarët e lirisë. Sipas Veselit, këto keqpërdorime janë bërë edhe nga ish-komandantë të lartë të UÇK-së. "Zemërimi im, që buron nga përfshirja e

mashtresve në listat e veteranëve, të cilat janë bërë nga disa komandantë abuzues, është arsyeja pse më shtyn të flas dhe të veproj. Duhet ta pranojmë faktin se jo pak njerëz në nivele të larta, edhe nga ish-UÇK-ja, për shumë vjet kanë abuzuar dhe po abuzojnë me fuqinë e tyre. Kjo duhet të marrë fund. Këta njerëz kanë dëmtuar më së shumti reputacionin e UÇK-së, kanë bërë që shumë njerëz të mendojnë se luftëtarët e vërtetë të UÇK-së kanë bërë atë që kanë bërë me qëllim për të përfutur", është shprehur ai.

Si një prej themeluesve të UÇK-së, Veseli ka thënë se nuk mund të rrijë indiferent karshi mashtrimeve që ndodhin në emrin e UÇK-së. "Prandaj, përmes grupit parlamentar të PDK-së, javën e ardhshme unë do ta inicioj krijimin e një komisioni hetimor parlamentar që do t'i hetojë dyshimet për mashtrimet në listat e veteranëve. Komisioni i vjetër qeveritar, si dhe i riu, do të ftohen nga ky komision hetimor parlamentar. Do të kërkohej të dorëzohen listat e veteranëve, të dhënat e pranimi ose refuzimit të deritashëm të kërkesave për statusin e veteranit, kriteret e përzgjedhjes, si dhe numri i ushtarëve dhe komandantëve në njësi dhe zona operative", ka thënë Veseli, duke shtuar se me këtë iniciativë do të ruhen nderi dhe reputacioni i UÇK-së dhe ushtarëve të saj.

Më tej, ai ka thënë se ky komision do të sigurojë që buxheti i Kosovës nuk do të dëmtohet

me dhjetëra miliona euro. "Nëse vazhdon dhe pranohet ky trend mashtrues, dëmi më i madh do t'u bëhet vetë veteranëve të UÇK-së sepse me Ligjin e miratuar në Kuvendin e Kosovës parashihet që shuma financiare për mbështetjen e veteranëve asnjëherë të mos e tejkalojë mbi 0.7 për qind e BPV-së. Aktualisht, është tejkualuar për afër 35 milionë euro. Në shifrat e përfitimeve financiare, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëse listat vazhdojnë të fryhen nga mashtruesit, atëherë për çdo veteran ulen përfitimet për rreth 40 për qind e të ardhurave aktuale", është shprehur ai.

Lideri i PDK-së ka treguar se në listën e mashtrimeve ka dyshime se ka njerëz që kanë

dorëzuar armët në policinë serbe ose edhe kanë qenë policë lokalë në vitet '90-ta. "Komisioni hetimor parlamentar, me punën e tij, duhet të sigurojë që listat e veteranëve të jenë të pastruara nga mashtruesit, në mënyrë që luftëtarët e UÇK-së që kanë nevojë të përkrahen edhe më shumë dhe më denjësisht nga shteti i tyre, për të cilin ata luftuan dhe ishin të gatshëm të vetësakrifikoheshin. Raporti final i këtij komisioni do të bëhet publik, bazuar në ligj, do të jetë në dispozicion të publikut dhe institucioneve të drejtësisë për t'i ndjekur penalisht mashtruesit", ka thënë ai, duke shtuar se, krahas komisionit, do t'i iniciojë edhe ndryshimet e duhura në Ligjin për Veteranët e Luftës së

UÇK-së, me praktikën më të mira të integritetit të tyre në kontributin e angazhimit zhvillimor. Ndër të tjera, Veseli ka bërë me dije se PDK-ja do të vazhdojë ta adresojë çdo shqetësim publik. "Kur para tre vjetësh nisa iniciativën për debimin e uzurpatorëve nga pronat publike, ju kujtohet, në opinion pat dyshime nëse një gjë e tillë vërtet do të mund të ndodhte pas 15 vjetësh uzurpimi. Ndodhi, dhe ata u larguan. Sundimit të ligjit iu bindën të gjithë dhe panë se drejtësia ishte e barabartë për të gjithë", ka thënë ai, duke përmendur edhe iniciativën e tij paraprake për krijimin e tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë.

Komisioni për Viktimat e Dhunës Seksuale zvarrit procesin, viktimat në ankth të dyfishtë

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Nga muaji shkurt i vitit të kaluar, prej kur ka filluar punën Komisioni për Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale, rreth 1 100 persona kanë aplikuar për këtë status. Por, më pak se gjysma kanë filluar t'i gëzojnë këto përfitime. Pensionin si

viktimë e dhunës seksuale kanë arritur ta marrin rreth 400 persona, ndërsa rreth 130 prej tyre janë refuzuar. Institucionet e Kosovës po punojnë shumë ngadalë për verifikimin e tyre, e aq më pak për t'i dënuar kryesisht e veprës. Të paktën kështu thonë organizatat që trajtojnë këto raste.

Drejtoresha e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Feride Rushiti, ka thënë për "KosovaPress" se procesi i njohjes ligjore të kësaj kategorie është duke shkuar shumë ngadalë për çka, sipas saj, viktimat po përjetojnë ankth dhe tension të dyfishtë.



Flet për "Epokën e re", Imri Ahmeti

Në shtator parashihet



Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Imri Ahmeti, e ka quajtur serioze iniciativën e kësaj partie dhe të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për ta larguar nga pushteti koalicionin PAN. Ai ka thënë se kjo iniciativë do të ketë sukses dhe, sipas tij, në shtator synohet rrëzimi i qeverisë dhe mbajtja e zgjedhjeve të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se opozita nuk llogarit në votat e deputetëve serbë për rrëzimin e qeverisë, por në votat që mund të vijnë nga koalicioni qeverisës. Ahmeti ka folur edhe për procesin zgjedhor brenda LDK-së, me ç'rast ka thënë se rrahjet nëpër disa degë nuk do të sjellin pakënaqësi të mëdha apo ndarje të partisë. Sipas tij, arsyeja e situatave të tensionuara nëpër këto degë është tendenca për ta ruajtur postin me çdo kusht

zgjedhjet", ka deklaruar ai. Sipas Ahmetit, kjo qeveri nuk do të mund ta përfundojë procesin e dialogut me Serbinë dhe do të mbahet mend për demarkimin e kufirit me Malin e Zi dhe për qëndrimet e ndryshme në mes të liderëve shtetërorë. "Nuk besoj se do të mund ta përfundojë këtë proces për shkak të dallimeve të mëdha që janë në mes të liderëve shtetërorë. Pikërisht edhe për këtë arsye duhet të mbahen zgjedhjet sepse na duhet një legjitimitet më i fortë dhe një qeverisje që do ta marrë përsipër dialogun në tërësi", ka theksuar ai.

Në këtë intervistë Ahmeti ka folur edhe për procesin zgjedhor brenda LDK-së, me ç'rast ka thënë se rrahjet nëpër disa degë nuk do të sjellin pakënaqësi të mëdha apo ndarje të partisë. Sipas tij, arsyeja e situatave të tensionuara nëpër këto degë është tendenca për të ruajtur postin me çdo kusht. "Unë jam i pakënaqur me procesin zgjedhor në disa degë në nivel vendi për arsye të tendencave të ruajtjes me çdo kusht të karriges së atyre që janë kryetarë dege dhe të pamundësisë së krijimit të një procesi fer në disa degë. Pra,

arsyeja e situatave të tensionuara nëpër disa degë është tendenca për ta ruajtur postin me çdo kusht", është shprehur Ahmeti.

"Epoka e re": Z. Ahmeti, partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), kanë marrë një iniciativë për të bashkëpunuar për rrëzimin e qeverisë Haradinaj. Si e shihni këtë dhe a ka gjasa që të ketë sukses apo do të mbetet vetëm në formë deklarative?

Ahmeti: Në fakt, janë përpjekjet më serioze deri më tani në këtë drejtim. Mendoj se do të gjendet një formulë e përbashkët edhe me deputetët e partive të tjera, sepse nuk mjafton vetëm numri i deputetëve të partive opozitare. Edhe pse mund të mos jetë e shpejtë brenda jave apo muaji, por në shtator më së largu do të ndodhë.

"Epoka e re": Pozita po ndihet komode dhe nuk po i frikësohet mocionit eventual të opozitës. Mund ta rrezikojë apo jo seriozisht opozita koalicionin qeverisës?

Ahmeti: Është normale sjellja e

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherësh kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka thënë të dielën se iniciativa e opozitës për rrëzimin e qeverisë është përpjekja më serioze deri më tani në këtë drejtim.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se në shtator parashihet rrëzimi i qeverisë. "Të gjitha rrethanat janë treguese të mjaftueshme se në shtator do të ketë rrëzim të qeverisë. Në këtë situatë në të cilën gjendet vendi ynë është e nevojshme që të kemi një proces zgjedhor këtë vit", është shprehur Ahmeti, duke

shtuar se, përveç zgjedhjeve, nuk ka alternativë tjetër. "Po i shohim dallimet esenciale në mes të krerëve institucionalë në përfaqësimin e vendit në institucione të ndryshme ndërkombëtare. Mendoj se vendit tonë nuk i duhen dy apo tre zëra të tillë, por i duhet një zë më unifikues dhe një legjitimitet më i fortë i institucioneve të reja që do të dalin nga

rrëzimi i qeverisë

pushtet. Nëse opozita është unike në tërësinë e vet, duke llogaritur këtu edhe PSD-në, gjithsesi iniciativa për rrëzimin e qeverisë është shumë serioze dhe do të ketë sukses.

"Epoka e re": Për rrëzimin e kësaj qeverie po llogarisni edhe në votat e Listës Serbe?

Ahmeti: Nëse dikush llogaritë që të mbetet në pushtet me votat e Listës Serbe është shumë normale të llogaritet që edhe të rrëzohet nga pushteti po me këto vota.

"Epoka e re": Keni siguruar ndonjë votë nga deputetët e koalicionit qeverisës?

Ahmeti: Ka indikacione të tilla dhe aktualisht opozita nuk llogarit në votat e deputetëve serbë, por llogarit në votat shtesë që mund të vijnë nga koalicioni qeverisës.

"Epoka e re": Sipas mendimit tuaj, në shtator do të ketë rrëzim të qeverisë dhe zgjedhje të reja?

Ahmeti: Të gjitha rrethanat janë treguese të mjaftueshme se në shtator do të ketë rrëzim të qeverisë. Në këtë situatë në të cilën gjendet vendi ynë është e nevojshme të kemi një proces zgjedhor këtë vit.

"Epoka e re": Pse mendoni se mbajtja e zgjedhjeve është zgjidhja e duhur?

Ahmeti: Sepse nuk ka alternativë tjetër. Po i shohim dallimet esenciale në mes të krerëve institucionalë në përfaqësimin e vendit në institucione të ndryshme ndërkombëtare. Mendoj se vendit tonë nuk i duhen dy apo tre zëra të tillë, por i duhet një zë më unifikues dhe një

legjitimitet më i fortë i institucioneve të reja që do të dalin nga zgjedhjet.

"Epoka e re": Si e vlerësoni qeverisjen e deritanishme dhe rolin opozitar?

Ahmeti: Nuk ka diçka të jashtëzakonshme me të cilën mund të krenohet qeveria aktuale. Kjo qeveri nuk ka lënë gjurmë të tilla, përveç një autostrade e cila lë për të dëshiruar sa iu përket shpenzimeve shtesë. Nuk e di a janë inskenime apo fakte këto dallime në mes të krerëve institucionalë, prandaj krejt çfarë do t'u mbetet në kujtesë qytetarëve gjatë këtyre gati dy vjetëve të qeverisjes janë qëndrimet e ndryshme të liderëve, kryesisht të presidentit dhe kryeministrit. Kjo qeveri mund të mbahet mend edhe për demarkimin e kufirit me Malin e Zi. Kurse sa i përket opozitës, ajo ka pasur një rol konstruktiv, nuk ka shkaktuar telashe siç ka qenë opozita e kaluar e cila ka përdorur edhe gaz lotsjellës në Kuvend të Kosovës. Kjo opozitë është treguar shumë më e pjekur dhe më kreative, duke ngritur tema të rëndësishme.

"Epoka e re": Pavarësisht prej pritjeve, ky koalicion nuk do të mund ta përfundojë dialogun me Serbinë? Ju si e shihni ecurinë e këtij procesi?

Ahmeti: Nuk besoj se do të mund ta përfundojë këtë proces për shkak të dallimeve të mëdha që janë në mes të liderëve shtetërorë. Pikërisht edhe për këtë arsye duhet të mbahen zgjedhjet sepse na duhet një legjitimitet më i fortë dhe një qeverisje që do ta marrë përsipër dialogun në tërësi.

Kryeministri aktual ju ka shmangur kësaj teme dhe e ka përcaktuar një delegacion shtesë i cili nuk mund ta përfaqësojë Kosovën. Qeveria e ardhshme duhet ta marrë vetë përgjegjësinë për dialogun me Serbinë.

"Epoka e re": Lidhur me këtë proces, prisni diçka pozitive nga Samiti i Parisit?

Ahmeti: Nuk mendoj se do të kemi finalizim të procesit. Sigurisht se do të vazhdohet të krijohet opinioni i përbashkët rreth zgjidhjes së temave të rëndësishme në kuptimin e dialogut me Serbinë, por finalizimin e dialogut nuk e pres në këtë samit.

"Epoka e re": Z. Ahmeti, si e komentoni procesin zgjedhor brenda LDK-së dhe kur pritet të mbahet Kuvendi i Përgjithshëm?

Ahmeti: Procesi ka pak telashe nëpër disa degë, por nuk janë aq të theksuara sa për të qenë shqetësuese për LDK-në. Procesi është duke u zhvilluar në shumicën e degëve tash në raundin e dytë dhe mendoj se në fund të qershorit do të përmbyllet. Edhe pse nuk jemi dakorduar ende në kryesinë qendrore të partisë për datën, mirëpo kah vjeshta mendoj se do të mbahet Kuvendi.

"Epoka e re": Gjatë këtij procesi kanë ndodhur edhe disa rrahje. Ka rrezik që këto zhvillime të çojnë në ndarje të partisë?

Ahmeti: Personalisht nuk mendoj se do të ndodhë një situatë e tillë. LDK-ja e ka provuar një situatë të tillë më herët dhe tashmë ka një pjekuri dhe maturi më të madhe. Nuk ka pasur konflikte, por tensione për shkak të numrit të madh

të anëtarësisë nëpër nëndegë për të marrë pjesë në zgjedhje. Unë jam i pakënaqur me procesin zgjedhor në disa degë në nivel vendi për arsye të tendencave të ruajtjes me çdo kusht të karriges së atyre që janë kryetarë degë dhe të pamundësisë së krijimit të një procesi fer në disa degë. Pra, arsyeja e situatave të tensionuara nëpër disa degë është tendenca për ta ruajtur postin me çdo kusht.

"Epoka e re": Mund të ketë zhvillime të tilla edhe në Kuvendin kur do të zgjedhet lideri i partisë?

Ahmeti: Nuk besoj se mund të ketë pakënaqësi të niveleve të mëdha, por mund të ketë pakënaqësi individuale. Pritet të shihet gjatë zhvillimeve të mëtejshme, mirëpo nuk ka indikacione të tilla që mund ta derivojnë një ndarje apo një grup pak më të madh që mund të shkaktojë telashe. Thjesht, ka ide të ndryshme dhe do ta shohim deri në fund të procesit. Pa u mbyllur procesi i degëve nuk ka edhe nominime për kryetar të LDK-së.

"Epoka e re": Megjithatë, janë përfolur disa emra dhe një pjesë e tyre nuk i kanë mohuar ambicinet në këtë drejtim. Për juve personalisht, kush duhet ta drejtojë LDK-në?

Ahmeti: Tash për tash nuk kam qëndrim lidhur me kandidatin e mundshëm për të vazhduar apo për ta marrë udhëheqjen e partisë. Kjo çështje sigurisht se do të dihet pasi të mbyllet procesi nëpër degë. Për ne është e rëndësishme që procesi të shkojë mirë, pastaj delegatët e degëve janë ata që do ta përcaktojnë kryetarin.

tillë e pozitës, sepse nuk mund të deklarohet e gatshme për këtë çështje përderisa është në

Thaçi: Nëse nuk ndryshon sistemi zgjedhor, largohem përgjithmonë nga politika

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar largimin nga skena politike nëse nuk zgjedhet president me votë të popullit edhe për një mandat të dytë. Në emisionin "Personale" në RTV "Dukagjini", Thaçi ka thënë se shqetësimi i tij më i vogël është se si do ta përfundojë karrierën politike. "Në parti nuk do të kthehem. As në Partinë Demokratike e as në ndonjë parti tjetër. Nuk do të kthehem në parlament si deputet. Nuk pretendoj për të rikandiduar për kryeministër apo për të udhëhequr ndonjë mandat të Qeverisë së Kosovës", ka thënë ai. I pari i vendit është lavdëruar për mënyrat se si është zgjedhur

kryeministër, duke kritikuar kryeministrat e tjerë të pasluftës. "Mendoj se kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës gjatë periudhës së luftës edhe pas, por edhe me dy mandate legjitime prej qytetarëve të Kosovës, jam i vetmi kryeministër i Kosovës që kam udhëhequr me mandat të plotë të fituar nga qytetarët. Gjithë të tjerët kanë qenë të emëruar apo në kombinime të ndryshme politike", ka deklaruar presidenti Thaçi. Ai ka thënë se i është mirënjohës spektrit politik që e ka votuar për president të Kosovës dhe se ai do të vazhdojë të jetë faktor unifikues. Ai ka dhënë edhe parashikimin për ta ardhmen e tij politike, për

mundësinë nëse do të kandidojë përsëri për president. "Nëse ndodhin ndryshime kushtetuese dhe mandati i ardhshëm i presidentit vendoset nga vota e drejtpërdrejtë e qytetarëve do të rikandidoj dhe jam i bindur se do të fitoj. Nëse mbetet sistemi i njëjtë, nuk do t'i lejoj vetes për shkak të parimeve dhe etikës të jem pjesë e ndonjë kalkulimi apo rizgjedhjeje të kuluareve politike të Prishtinës. Pra, nëse mbahen zgjedhjet presidenciale me votë të drejtpërdrejtë nga populli, do të kandidoj dhe të zgjedhem edhe një mandat; nëse jo, do t'i them lamtumirë politikës përgjithmonë", ka thënë Thaçi.



Kosova, shembull unik për tolerancën dhe bashkëjetesën ndërfaqetare

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro Parolin, ka vizituar të dielën për herë të parë Republikën e Kosovës. Kardinali Pietro Parolin ka qëndruar për një vizitë në katedralen "Shën Nënë Tereza" në Prishtinë, ku është pritur nga Ipeshkvi i Kosovës, imzot Dodë Gjergji. Me këtë rast, sekretari i Shtetit të Vatikanit ka takuar, me rastin e një pritje solemne, edhe kryemiytiun e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnavë, zëvendëskryeministrin Enver Hoxhaj, diplomatë, ambasadorë dhe deputetë të Kosovës, si dhe besimtarë të shumtë.

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë se kjo vizitë e kardinalit Pietro Parolin, e para e nivelit të lartë, flet për afrimin e marrëdhënieve të Kosovës me Selinë e Shenjtë në aspektin bilateral dhe atë shoqëror. "Vatikanit ka qenë gjithmonë përkrahës i pavarësisë së Kosovës, ndërsa në këtë fazë finale të shtetndërtimit është e domosdoshme që marrëdhëniet tona t'i lëvizim drejt njëjtes", ka thënë Hoxhaj. Ai e ka



falënderuar për vizitën në Kosovë kardinalin Parolin dhe për mbështetjen e Selisë së Shenjtë për Kosovën dhe fuqizimin e marrëdhënieve tona bilaterale përmes vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.

Edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, i cili ka marrë pjesë në ceremoninë e organizuar nga Ipeshkvi i Kosovës, imzot Dodë Gjergji, me rastin e vizitës së kardinalit Pietro Parolin, sekretar i

Shtetit të Vatikanit në katedralen "Nënë Tereza". Me këtë rast, ambasadori Dedaj ka thënë se Kosova është shembull unik për tolerancën dhe bashkëjetesën ndërfaqetare. "Toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa ndërfaqetare dhe ndëretnike është vlerë dhe shembull unik në Republikën e Kosovës. Njohja e pavarësisë së Kosovës nga Shteti i Vatikanit mbetet në agjendën e diplomacisë së Kishës Katolike dhe të autoriteteve më të larta të Vatikanit", ka thënë Dedaj.



Kosova do të jetë nikoqire e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Kalendarit të ngjarjeve kulmore me karakter ndërkombëtar, që organizohen në Republikën e Kosovës, i shtohet edhe një ngjarje shumë e rëndësishme. Asambleja e Përgjithshme e Organizatës për Cilësi në Evropë do ta organizojë takimin e saj në Prishtinë, këtë muaj. Kjo ngjarje e karakterit kaq të lartë zhvillohet për herë të parë në vendin tonë. Nikoqire e saj do të jetë organizata "Quality Kosova", nën udhëheqjen e presidentit, prof. dr. Edmond Hajrizi.



"Quality Kosova" u themelua në vitin 2006, me iniciativë të rektorit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi. Ajo merret me çështjen e promovimit të cilësisë, standardëve, certifikimeve dhe konfirmimit të bazuar në standardet evropiane dhe ndërkombëtare në Kosovë,

njëkohësisht promovon edhe vlerat e Kosovës jashtë vendit përmes pjesëmarrjes në konferenca profesionale dhe shkencore në mbarë botën.

Asociacioni kosovar "Quality Kosova" që nga viti 2013 është anëtar i rregullt dhe me të drejta të

plota në Organizatën Evropiane për Cilësi, ku e përfaqëson Kosovën. Organizata Evropiane për Cilësi është ombrella e organizatave nacionale të Evropës, të cilat promovojnë standardet më të mira të cilësisë dhe aspekteve me rëndësi të jetës në Evropë dhe më gjerë. "Është hera e parë që Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Evropiane mban një takim kaq të lartë në regionin e Ballkanit Perëndimor. Për Kosovën kjo ngjarje ka rëndësi të veçantë, sepse me këtë rast edhe ne

tregojmë se përkrahim dhe implementojmë pjesë të vlerave evropiane në Kosovë", ka thënë Edmond Hajrizi.

Takimi i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë do të mbledhë në Prishtinë përfaqësues nga të gjitha vendet e Evropës, që përfaqësojnë organizatat e tyre nacionale për menaxhimin e cilësisë, standardeve dhe certifikimeve, profesionistë dhe ekspertë të dalluar nga industri të ndryshme dhe me renome botërore.

Marrëveshja e Kumanovës i dha fund kapitullimit të Millosheviqit

PRISHTINË, 9 QERSHOR (ER) - Të dielën janë bërë 20 vjet nga Marrëveshja e Kumanovës, e cila i dha fund luftës ndërmjet UÇK-së dhe forcave ushtarake serbe.

Kjo bëri që të dorëzohet edhe ushtria e Jugosllavisë dhe kapitullimit i kriminelit Sllobodan Millosheviq.

Njëzet vjet më parë në Kosovë erdhën trupat e para të këmbësorisë së NATO-s dhe filloi edhe largimi i ushtrisë serbe. Me këtë rast, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se në këtë ditë, 20 vjet më parë, Millosheviq dhe ushtria e tij u dorëzuan para NATO-s. "Marrëveshja e Kumanovës do të

thotë çlirim, fund i gjenocidit, paqe dhe fillim i jetës së re në liri dhe barazi për ne. Ishte një rrugëtim i dhimbshëm, por krenar për rindërtimin e vendit dhe shoqërisë sonë. Për botën ishte një fitore e të drejtave të njeriut mbi çdo cenim në shekujt e mëparshëm. Me respektin më të madh e kujtojmë çdo sakrificë të çdo kombi që iu bashkua NATO-s në këtë luftë të drejtë. Me dhimbje, por gjithmonë duke u krenuar me heroizmin e tyre, e kujtojmë edhe çdo dëshmor që ka rënë për ta bërë realitet ëndërrën tonë. U jemi përjetësisht mirënjohës", ka shkruar

Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se 20 vjet më parë në Kumanovë u nënshkrua marrëveshja e cila përfundimisht i dha vulë të drejtës sonë për të jetuar në liri. "Kjo marrëveshje e kapitullimit të Millosheviqit ndali vazhdimin e gjenocidit, agresionit dhe spastrimit etnik. NATO në këtë triumf të përbashkët me popullin e Kosovës përcaktoi se e drejta e njerëzve tanë për ta thyer okupimin është e drejtë njerëzore", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Çdo vit Komisioni Evropian përsërit rekomandimet e njëjta për Kosovën



PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ka vite që një numër i konsiderueshëm rekomandimesh përsëriten në raportet e përvitshme të Komisionit Evropian (KE) për Kosovën. Ngjashëm me disa prej raporteve të kaluara, edhe këtë vit raporti i vendit për Kosovën, i këtij institucioni të Bashkimit Evropian (BE), ndër të tjera, shpreh shqetësimin për ndikimin e politikës në sistemin e drejtësisë, nivelin e lartë të përhapjes së korrupsionit, ekonominë joformale e ngecjen në reformën zgjedhore.

Në shumicën e këtyre fushave, sipas raportit, është shënuar përparim i vogël. Ndërsa shumë prej rekomandimeve, për secilin nga institucionet përgjegjëse, mbesin të paadresuara. Përsëritja e rekomandimeve, për shkak të mosadresimit të tyre nga institucionet, sipas shoqërisë civile, është shqetësuese dhe tregon mungesë serioziteti dhe përkushtimi.

Taulant Kryeziu nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK) ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se përfaqësuesit shtetërorë "duhet t'i marrin me shumë seriozitet kërkesat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian" pasi, sipas tij, "pa

adresimin e tyre nuk mund të ketë lëvizje përpara në proceset integruese". "Gjuha (e raportit) vazhdon të mbetet e njëjtë, ku drejtësia vuan nga ndikimi i politikës. Ne kemi parë në rezolutën e nëntorit të Parlamentit Evropian, që Kosova është një shtet i kapur, ku korrupsioni është i përhapur në të gjitha institucionet. Prapë gjuha sa i përket korrupsionit është e njëjtë në Raportin e Vendit, prandaj asgjë të mos i befasojë udhëheqësit institucionalë. Mirëpo, duhet ta kuptojnë një gjë, pa adresimin e këtyre kërkesave që ka Bashkimi Evropian, ne nuk mund të ecim përpara as në procesin teknik të vizave, as në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian. E kjo i bie aplikim për statusin e vendit kandidat", ka thënë ai.

Ndërsa Arbëresha Loxha, drejtoreshë ekzekutive në Grupin për Studime Juridike dhe Politike, ka thënë se mosadresimi i kërkesave dhe rekomandimeve në Raportin e Vendit për vite me radhë po e largon Kosovën nga synimi për integrim në Bashkimin Evropian. "Raporti i fundit nuk dallon shumë prej atyre paraprakë. Nuk na ka sjellë asnjë befasi. Në shumicën e sektorëve raporti vëren që progresi i Kosovës është i

pa përfillshëm dhe mesazhet dhe kërkesat e BE-së ndaj Kosovës mbesin të njëjta me vitet e kaluara. Pra, të gjitha kërkesat dhe mesazhet e BE-së po na përsëriten dhe rekomandimet, pothuajse, vazhdojnë të mbesin të njëjta. Kjo përveçse reflekton paaftësinë e institucioneve të Kosovës, që me përgjegjshmëri t'i adresojnë çështjet e viteve të kaluara, është njëkohësisht sinjal që Kosova është duke u larguar nga objektivi i saj themelor, anëtarësimi në Bashkimin Evropian", ka theksuar Loxha.

Ndërkohë, Kryeziu theks të veçantë vë në kërkesat dhe rekomandimet që lidhen me sistemin e drejtësisë, sundimin e ligjit dhe depolitizimin e bordeve, ndërmarrjeve dhe agjencive të pavarura. "Ndikimi politik në të gjitha institucionet e pavarura, bordet, në agjencitë, zbatimin e ligjit, është evidentuar edhe në këtë raport të vendit. Prandaj, të gjitha këto janë sfida, të cilat në vazhdimësi janë duke e përcjellë vendin tonë. Por, kryefjalën e procesit të integritetit evropian, duhet ta kuptojnë udhëheqësit institucionalë të Republikës së Kosovës, se është sundimi i ligjit. Pa një drejtësi të pavarur nga politika, me njerëz me integritet,

që janë të aftë për t'i hetuar dhe gjykuar profilet e larta, nuk mund t'u ofrohet perspektivë evropiane qytetarëve të vendit", ka theksuar Kryeziu, drejtor i programeve dhe kërkimeve në EPIK.

Sipas Kryeziut, derisa sistemi i drejtësisë "vazhdon të vuajë nga ndikimi i politikës", Kosova nuk është duke përmbushur as obligimet kontraktuale me BE-në. Ai thotë se Kosova ka mbetur prapa në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe se ka përmbushur vetëm pesë (5) nga njëzetedy (22) prioritetet e Agjendës Evropiane.

Ditë më parë ministrja për Integrim Evropian, Dhurata Hoxha, në një takim të Këshillit Ndërmintor për Integrim Evropian, tha se Kosova "duhet t'i adresojë këto sfida në mënyrë që vlerësime të tilla të mos përsëriten më". "Është e papranueshme, gjithashtu, sa i përket Raportit të Vendit, që një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve na përsëriten ndër vite. Dhe, kemi ende shumë punë për të bërë te zbatimi i legjislacionit, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër ekonomisë joformale, reforma zgjedhore, këto janë të gjitha të

gjetura të cilat i kemi evidentuar edhe ne vetë. Ne duhet të jemi titullarë në adresimin e këtyre sfidave dhe që vlerësime të tilla të ngjashme të mos përsëriten. Nuk kemi kohë dhe hapësirë për tolerime të tilla, sidomos kur është në pyetje mirëqenia e qytetarëve tanë", ka thënë ministrja Hoxha.

Hoxha, po ashtu, tha se "të gjeturat shqetësuese kërkojnë seriozitet më të lartë dhe veprim të menjëhershëm" nga të gjitha institucionet e vendore, ndërsa shtoi se ngecjet e evidentuara në Raportin e Vendit duhet të jenë "alarmi i fundit, për të dëshmuar që Kosova është e përkushtuar në synimet e saj strategjike për integrim në BE".

Komisioni Evropian ka publikuar paketën vjetore të zgjerimit, e cila përcakton përparimin që kanë bërë vendet që synojnë integrimin në Bashkimin Evropian. Pakoja e zgjerimit paraqet dokumentin më të rëndësishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, ku objektivi është përcaktuar gjendja faktike në çdo vend dhe vlerësohet përparimi, por edhe mangësitë për përmbushjen e kriterëve në procesin e integritetit.

Në Gjykatën e Apelit janë vetëm dy gjyq



Në Gjykatën e Apelit aktualisht janë vetëm dy gjyqtarë që merren me çështje ekonomike. Në këtë gjykatë janë të pakryera 477 lëndë të cilat janë trashëguar nga vitet paraprake. Numri i vogël i gjyqtarëve për çështje ekonomike është kritikuar nga përfaqësuesit e bizneseve, Berat Rukiqi dhe Skender Krasniqi. Se gjykata komerciale është e nevojshme, këtë e thotë edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sistemi ynë i drejtësisë ka nevojë për themelimin e një gjykate të re komerciale e cila do t'i trajtonte ekskluzivisht lëndët e kësaj natyre

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Zëdhënësi i Gjykatës së Apelit, Arbër Jashari, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re", se në Gjykatën e Apelit janë vetëm dy gjyqtarë që merren me çështje ekonomike. Sipas tij, aktualisht janë të pakryera 477 lëndë të cilat janë trashëguar nga vitet paraprake. "Në Gjykatën e Apelit aktualisht kemi vetëm dy gjyqtarë që merren me këtë çështje. Gjatë vitit 2018 në Gjykatën e Apelit kemi pranuar 340 lëndë të natyrës ekonomike, ndërsa kemi kryer 237 sosh", është shprehur Jashari, duke shtuar se për pesëmujorin e parë të këtij viti

presin të marrin epitet edhe 34 lëndë. "Në pesëmujorin e parë të këtij viti janë pranuar 213 lëndë, ndërsa janë zgjidhur 179 sosh. Aktualisht kemi të pakryera 477 lëndë, të cilat janë trashëguar nga vitet paraprake", është shprehur ai.

Në pyetjen nëse është sfidues numri i limituar i personelit në këtë gjykatë, Jashari është përgjigjur: "Natyrisht që është sfidues. Gjykata e Apelit gjatë vitit 2017 dhe 2018 ka pasur vetëm një gjyqtar në këtë departament. Prej janarit i kemi dy gjyqtarë. Është e nevojshme që atyre t'u ofrohet përkrahje teknike dhe profesionale me staf mbështetës siç janë: zyrtarët ligjorë dhe bashkëpunëtorët profesionalë,

por edhe këshilltarë ligjorë. Gjykata është duke punuar në këtë drejtim".

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se ankesat e bizneseve janë të natyrës komerciale dhe se grumbullimi i lëndëve është sinjal negativ për investitorët e huaj. "Ankesat e bizneseve ndaj sistemit gjyqësor janë të natyrës komerciale në të dyja rastet komerciale të shqyrtimit. Përveç numrit të vogël, ka mungesë edhe të ekspertizës nga ana e gjyqtarëve. Ne kemi propozuar gjykatë të re për çështje komerciale dhe kjo është në agjendën e komunikimit dhe veprimit me Ministrinë e Drejtësisë. Siguria juridike është 'thembra e Akilit'

në tërheqjen dhe rritjen e investimeve të huaja direkte, prandaj duhet të jemi më vigjilent në këtë drejtim", është shprehur Rukiqi.

Edhe kreu i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skender Krasniqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se numri i madh i lëndëve ekonomike të grumbulluara në gjykata është stimulues për ardhjen e investitorëve të huaj dhe për ambientin e të bërit biznes në Kosovë. "Numri i madh i lëndëve ekonomike të pagjdhura është duke e penguar ardhjen e investitorëve të huaj, pasi ankesat kryesore janë për mospagesa të rregullta të cilat nuk kryhen brenda afateve të caktuara, ndërsa në shtetet e jashtme intervenimi i shtetit do të ishte i menjëhershëm qoftë përmes Ligjit të falimentimit apo masave të drejtpërdrejta. Lëndët që shkojnë në gjykata do të duhej që me ligj t'u përgjigjeshin brenda 30 ditëve dhe jo të mbesin me vite nëpër sirtar ashtu siç ndodh te ne. Asnjëherë institucionet e Kosovës nuk kanë investuar që të ketë gjykatës profesioniste", ka thënë Krasniqi. Ai ka folur edhe për Gjykatën Ekonomike

që, sipas tij, në mungesë të kësaj gjykate po grumbullohen lëndët.

Kurse prodhuesi vendor, Burim Piraj, ka thënë se biznesi që ai drejton kohët e fundit nuk ka pasur lëndë të proceduar për Gjykatën e Apelit, por që kanë vërejtje për numrin e vogël të gjyqtarëve në Apel. "Sa i përket kompanisë sonë, së fundmi nuk kemi pasur nevojë t'i drejtohem Gjykatës së Apelit, mirëpo dihet se shumë kompani kanë shumë nevojë që lëndë të ndryshme kontestuese që i kanë me Doganën ose me ATK-në presin që t'u shqyrtohen sa më parë. Shumë lëndë që i preokupojnë bizneset rrjedhin nga keqkuptimet me Doganën ose me ATK-në. Këto gjëra po përsëriten që 20 vjet dhe nuk po ndërmerret asgjë", ka thënë Piraj për gazetën "Epoka e re".

Gazetari maqedonas Aleksandar Manasiev, i cili ka fituar shumë çmime në fushën ekonomike, ka thënë se sistemi i drejtësisë për lëndë ekonomike është i njëjtë në vendet e rajonit, përderisa përmendi shembuj nga vendi i tij ku gjykatësit nuk janë në

tarë që merren me çështje ekonomike

nivel të duhur. Ai ka thënë se për të pasur gjyqtarë të mirëfilltë të fushës ekonomike duhet që të ketë edukim dhe trajtime të vazhdueshme për ta. "Tek sistemi juaj mendoj se

nuk janë të mjaftueshëm vetëm dy gjyqtarë për çështje ekonomike. Gjyqtarët duhet të jenë shumë profesionistë dhe të kenë njohuri specifike për lëndët në fjalë. Nëse mbulojnë

lëndët ekonomike ata duhet vazhdimisht të jenë të edukuar dhe trajnuar. Kemi disa raste në Maqedoni kur gjyqtarët nuk e dinin çfarë është çështja apo subjekti

kryesor i lëndës, pra nuk dinin rreth ekonomisë dhe gjërave kibernetike në internet. Ata thjesht nuk i kuptonin gjërat elementare", është shprehur Manasiev.

Tahiri: Sistemi i drejtësisë ka nevojë për themelimin e një gjykate të re komerciale

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në Kosovë ka nevojë të themelohet një gjykatë e re komerciale e cila do të merrej ekskluzivisht me lëndët e natyrës ekonomike. "Çështja e akumulimit të lëndëve dhe kapaciteteve të pamjaftueshme s'është temë e re brenda sistemit të drejtësisë, por të reja janë iniciativat tona për t'ua dhënë një epilog racional këtyre problemeve me të cilat ende vazhdojnë të ballafaqohen qytetarët në përgjithësi dhe bizneset në veçanti. Një numër i madh lëndësh vazhdon të qarkullojnë nëpër gjykatat tona, e ndër to numri i lëndëve të pazgjidhura ka qenë mjaft domethënës veçmas në Departamentin për Trajtimin e Lëndëve të Karakterit Komercial, si në Gjykatën Themelore të Prishtinës, po ashtu edhe në Gjykatën e Apelit", ka thënë

Tahiri, duke shtuar se në kuptimin e përgjithshëm vitin e kaluar kanë stimuluar rritjen e buxhetit për Këshillin Gjyqësor, pikërisht për t'i dhënë mundësi rritjes së numrit të stafit gjyqësor për të ndikuar kështu edhe në përshpejtimin e trajtimit të këtyre lëndëve. "Në anën tjetër, çështjen e akumulimit të lëndëve e kemi trajtuar me prioritet në kuadër të Agjendës 'Drejtësia 2020', ku për një periudhë të shkurtër kohore pritet që lëndët e pazgjidhura me vite, përfshirë ato që kanë për subjekt sferën e biznesit, do të zgjidhen shumë shpejt. Por, si ministër i Drejtësisë kam pasur një fokus dhe vazhdoj të besoj se Republika e Kosovës dhe sistemi ynë i drejtësisë ka nevojë për themelimin e një gjykate të re komerciale, e cila do t'i trajtonte ekskluzivisht lëndët e kësaj natyre. Në kuadër të

procesit të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit, një shtyllë e tërë i është kushtuar hulumtimit të alternativave që do të ishin të përshtatshme për ne si vend që të ndërmarim një hap të tillë. Si shtet i hapur për investime të huaja dhe si shtet ku biznesi privat është gjeneruesi më i madh i punëzënies dhe taksave që derdhen në buxhetin e shtetit, besoj se është koha e duhur që kësaj kategorie t'i krijojmë një ambient më efikas për trajtimin e lëndëve të tyre", ka thënë Tahiri.

Ai ka shtuar se janë në proces të hartimit të Strategjisë për Sektorin e Rendit dhe Ligjit. "Jemi në proces e sipër të hartimit të Strategjisë për Sektorin e Rendit dhe Ligjit dhe në kuadër të rekomandimeve të saj, do t'i shtrojmë përpara argumentet që flasin në dobi të krijimit të një gjykate të

tillë. Në përputhje me këtë ide kanë qenë edhe bizneset e të gjitha rajoneve të Kosovës me të cilët kam zhvilluar takime të shpeshta dhe odave ekonomike që operojnë në Kosovë. Në anën tjetër, për t'i kontribuar kësaj klime, kemi ndryshuar dhe jemi duke ndryshuar legjislacionin në segmente të rëndësishme, siç është inkuadrimi i ndërmjetësimit si pjesë integrale e profesioneve të lira ligjore ku, krahas përmbaruesve, noterëve dhe administratorëve falimentues, edhe ndërmjetësuesit do të jenë aset shtesë për qasjen më të shpejtë në drejtësi. Po ashtu, për herë të parë jemi duke u bërë me Kod Civil dhe ligje të tjera që derivojnë nga pakoja e të Drejtave Pronësore, që do të arrijnë një efekt shumë pozitiv në klimën e të bërit biznes në Republikën e Kosovës", është shprehur ministri Tahiri.

Sivjet Kosova pret rendimente të ulëta të grurit

PRISHTINË, 9 QERSHOR- Kosova edhe gjatë këtij sezoni pritet të ketë rendimente të ulëta të grurit. Edhe pse gruri është kultura kryesore që për një kohë të gjatë zë sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore, asnjëherë deri më tani nuk është arritur që t'i plotësojë nevojat e popullatës me këtë kulturë, marrë parasysh rëndësinë që ka për prodhimin e miellit. Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës theksojnë se gjatë këtij viti pritet të ketë prodhim më të ulët të grurit për shkak të kushteve klimatike që kanë mbizotëruar në vjeshtën e kaluar. Kushtet klimatike, sipas tyre, kanë ndikuar që të mbillen me këtë kulturë bujqësore vetëm 50 mijë hektarë sipërfaqe tokë. Isuf Cikaqi, drejtor në Departamentin për Politika Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, thotë se pritet sasi më vogël e prodhimit por, megjithatë, rendimenti mesatar i grurit për këtë vit pritet të jetë në suaza normale që në Kosovë është nga 3 500 deri në 4 500

kilogramë për hektarë, varësisht nga parcelat dhe rajoni. "Këtë vit janë të mbjella (mbjellja vjeshtore) më pak sipërfaqe në raport me vitin e kaluar dhe vitet e tjera. Edhe sasia e grurit që është mbjellë është mbjellë me vonesë. Gjithsejtë nga informatat që kemi marrë nga terreni, janë mbjellë 50 mijë hektarë, që në raport me vitet e tjera, janë 20 mijë hektarë më pak", ka thënë Cikaqi për "Radion Evropa e Lirë". Vitin e kaluar 74 mijë hektarë sipërfaqe kanë qenë të kultivuara me kulturë të grurit. Sipas të dhënave zyrtare, në Kosovë nevojat për këtë produkt për kokë banori janë 205 kilogramë, që i bie se në Kosovë duhet të harxhohen 410 mijë tonë grurë. Edhe ekspertë të bujqësisë pohojnë se në Kosovë gjatë këtij viti nuk do të arrihet prodhimtaria e planifikuar e grurit. Profesori në Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës, Imer Rusinovci, ka thënë për "Radion Evropa e



Lirë" se as 50 për qind e sipërfaqeve të planifikuara nuk janë kultivuar me grurë për shkak të kushteve atmosferike që kanë mbizotëruar në muajin tetor dhe nëntor të vitit të kaluar. Kështu që, sipas tij, Kosova edhe në të ardhmen do të varet nga importi i grurit nga shtet tjera. Përveç kushteve klimatike,

arsye tjetër e zvogëlimit të sipërfaqeve me grurë Rusinovci përmend dekurajimin e fermerëve nga autoritetet kompetente që nuk kanë gjetur metoda të duhura për t'i nxitur ata për prodhime strategjike. Për ta rritur interesimin e fermerëve për mbjelljen e sipërfaqeve më të mëdha me grurë, Ministria e Bujqësisë ka disa vjet që subven-

cion fermerët me nga 150 euro në vit, kurse sipërfaqja minimale e mbjell me grurë duhet të jetë 2 hektarë në pronësi të fermerit. Sipërfaqja e përgjithshme në Kosovë është mbi 10 908 km katrorë, kurse 53 për qind e tokës është bujqësore. Ndërkaq, nga 1.9 milion banorë, 61 për qind prej tyre jetojnë në zonat rurale.

Mitrovica përkujton martirët e fshatit Koshtovë

MITROVICË, 9 QERSHOR (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica", buzë lumit Ibër, është mbajtur një akademi përkujtimore me rastin e 20-vjetorit të rënies së martirëve, Hajriz Miftari, Ahmet Miftari, Lulzim Miftari, Halil Miftari, Fatmir Miftari dhe Besim Miftari nga fshati Koshtovë i Mitrovicës.

Të pranishëm në këtë akademi ishin kryetari i komunës, Agim Bahtiri, nënkryetari Faruk Mujka, Milaim Zeka, deputet i Kuvendit të Kosovës, drejtorë komunalë, familjarë të dësh-

morëve dhe veteranëve të luftës, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta si dhe shumë qytetarë të tjerë. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka thënë se "është mirë që po organizohen tubime të këtilla përkujtimore përmes të cilave kujtojmë kontributin e jashtëzakonshëm që kanë dhënë trimat tanë për çlirimin e atdheut". "Shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Miftari, e cila në kohë të luftës humbi anëtarët më të ngushtë të familjes. Ne sot jemi mbledhur këtu për t'i përkujtuar martirët e fshatit Koshtovë, të cilët dhanë jetën e tyre për të shtrenjtën liri. Falë gjakut të

dëshmorëve, martirëve dhe të gjithë të rënëve, por edhe falë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe miqve tanë ndërkombëtarë, ne sot kemi një shtet të pavarur, një liri të cilën më parë s'e kishim, andaj sot më shumë se kurrë duhet të jemi të bashkuar për të mirën e vendit dhe për ta dërguar në vend amanetin e këtyre martirëve si dhe të gjithë të rënëve", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa përfaqësuesi i familjeve për personat e pagjetur, Bajram Qerkini, ka theksuar se edhe pas 20 vjetëve ende nuk kanë arritur t'i kthejmë të gjithë trupat e të rënëve për liri.



Komuna e Gjiçanit kërkon nga bizneset vendosjen flamurit shtetëror për ditët e çlirimit

Gjiçan, 9 qershor (ER) - Komuna e Gjiçanit, përkatësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës së Gjiçanit, ka kërkuar nga të gjitha bizneset private që ta vendosin

flamurin e Republikës së Kosovës në kompanitë e tyre prej datës 11 deri 15 qershor, në kuadër të shënimit të Ditës së Çlirimit të Gjiçanit. "Kërkesa buron nga Ligji i përdorimit të

flamurit të Republikës së Kosovës. Ky akt do t'i jepte madhështi Ditës së Çlirimit të Gjiçanit. Ju faleminderit për bashkëpunim!", ka njoftuar Komuna e Gjiçanit.

Latifi viziton fabrikën nga Rahoveci që eksporton produkte në Zvicër

Rahovec, 9 qershor (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Artan Asllani, dhe ai i Drejtorisë për Shërbime Publike, Përparim Krasniqi, kanë vizituar fabrikën për prodhimin e telit, "C&G Materiali", në Drenoc të kësaj komune. Pas kësaj vizite, Latifi ka bërë me dije se kjo fabrikë eksporton produktet e saj në Zvicër. "Vëllezërit Gashi nga Drenoci, të cilët jetojnë në Zvicër në krye me Nazim Gashin, pronarin e kompanisë,

kanë arritur të investojnë në Kosovë duke hapur këtë fabrikë dhe duke siguruar vende pune për familjet tona. Fabrika eksporton produkte në Zvicër. Është kompania e vetme në Ballkan që eksporton 100 për qind në tregun e Zvicrës. Është një nga kompanitë më cilësore atje. Jemi krenarë me këto investime të mërgatës në Kosovë dhe, njëkohësisht, si komunë do të vazhdojmë të punojmë shumë që të krijojmë një mjedis sa më tërheqës ekonomik për investime nga mërgata", ka thënë Latifi.



Ansambli 'Dëshmorët e kombit' nga Obiliqi, fitues i Festivalit 'I këndojmë lirisë'

Klinë, 9 qershor (ER) - Në Klinë ka përfunduar Festivali Folklorik Mbarëkombëtar "I këndojmë lirisë", i cili është mbajtur më 6, 7 dhe 8 qershor. Çmimin kryesor "Mujë Krasniqi" të edicionit të 19 të këtij festivali e ka fituar Ansambli i Këngëve dhe i Valleve "Dëshmorët e Kombit" nga Obiliqi. Këtij ansambli çmimin ia ka dorëzuar kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, dhe Halil Krasniqi, babai i komandant Mujë Krasniqit. Vendin e dytë në këtë festival e ka marrë ansambli "Drenica" nga Skenderaj, vendin e tretë "Shotë Galica" nga Drenasi, ndërsa çmimi i publikut i ka takuar Ansambli të

Këngëve dhe Valleve të Lushnjës. Udhëheqësi artistik i këtij ansambli, Sadat Kelmendi, ka thënë se janë të nderuar që janë fitues të çmimit të publikut. "Në këtë manifestim folklorik mbarëkombëtar ne marrim pjesë që disa vjet. Sivjet jemi përgatitur si kurdoherë më parë. Ky shpërblim na obligon të punojmë edhe më shumë ngaqë jemi vlerësuar nga një juri profesionale", ka thënë Kelmendi. Ndërsa kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në festival, duke u dëshiruar pjesëmarrje të sërishme edhe në festivalet e ardhshme. "Ne si komunë e



kemi mbështetur Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar 'I këndojmë lirisë' duke bërë të mundshme që festivali ta përmbushë

qëllimin, sepse festivali për Klinën është shumë domethënës, për karakterin dhe cilësinë, duke u bërë tashmë tradicional dhe iden-

tifikues", është shprehur kryetari Elezaj. Edhe drejtuesit e tjerë të festivalit janë shprehur të kënaqur me rrjedhën e festivalit, pjesëmarrjen, mbarëvajtjen dhe pjesëmarrjen e grupeve dhe rapsodëve. Drejtori i Festivalit "I këndojmë lirisë", Alban Gashi, ka theksuar se janë të impresionuar me pjesëmarrjen në këtë festival. Sivjet festivali është mbajtur në një ambient të përshtatshëm në Sheshin "Mujë Krasniqi", përkrah shtatores së komandantit të UÇK-së, Mujë Krasniqit-"Kapuçit".

(Enver Maloku, zëdhënës i Festivalit "I këndojmë lirisë")

Klientelizmi dhe korrupsioni, Shqipëria në prag të katastrofës



Nga Janusz BUGAJSKI

Shqipëria duhet të shmangë me çdo kusht rënien në konflikte dhe kaos, pasi pasojat mund të jenë më të mëdha sesa e rënia e shtetit që dëshmuam para më shumë njëzet vitesh. Radikalizmi politik, protestat e dhunshme, trazirat sociale dhe paqëndrueshmëria institucionale jo vetëm që e zvarrisin vendin drejt një krize të brendshme, por gjithashtu mund të krijojnë paqëndrueshmëri rajonale, të bllokojnë integrimin e Shqipërisë në BE dhe të përkeqësojnë marrëdhëniet e saj me Shtetet e Bashkuara. Në krahasim me shembjen ekonomike të vitit 1997, sot, "skemat piramidale" në Shqipëri janë si politike ashtu edhe ekonomike. Klientelizmi dhe korrupsioni kanë infektuar thellësisht të dy partitë kryesore, ndërkohë që një alternativë e tretë konkrete mungon. Por, edhe më keq se korrupsioni i zyrtarëve është polarizimi ekstrem i politikës në Shqipëri. Edhe pse të gjithë vendet në rajonin e Ballkanit janë të ndikuara nga lidhjet fitimprurëse midis politikës dhe biznesit, asnjëra prej tyre

nuk ka përjetuar çrregullime akute bipolare si ata të Shqipërisë.

Kosova ka një sistem të prekshëm shumëpartiak, me të paktën katër formacione të mëdha në garën për pushtet. Në Mal të Zi edhe pse politika është e ndarë në mes grupimeve malazeze dhe serbe, partitë pro pavarësisë janë më të forta dhe kanë arritur ta mbajnë pushtetin duke kaluar nga disa cikle zgjedhore. Maqedonia e Veriut, edhe pse ka dy parti të mëdha, për shkak të rolit të rëndësishëm që partitë shqiptare marrin në koalicionet qeverisëse, parlamentin funksionon ndërsa qeveria është në gjendje të bëjë marrëveshje të rëndësishme me fqinjët e saj.

Rasti i Shqipërisë është ndryshe; ajo është e mbërthyer në një "moçal", ku ndërsa besimi në të dyja palët bie, militantët mbizotërojnë dhe kompromiset midis liderëve politikë nuk arrihen dot. Bojkotimi i parlamentit dhe i zgjedhjeve mund të duket si një formë radikale proteste, por, në fund të fundit, kjo është një metodë vetëshkatërruese, meqë ul besimin e njerëzve në institucionet shtetërore.

Pasi braktisi vendet e veta në parlament, Partia Demokratike në opozitë, i ka bërë thirrje qeverisë të Partisë Socialiste të japë dorëheqjen dhe kërkon që vendi të drejto-

het nga një qeveri e përkohshme deri në përfundim të zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme. Veçse, zgjedhjet kombëtare të mbajtura pa ndonjë pazar të madh midis aktorëve kryesorë politik thjesht do të prodhojnë pakënaqësi tek humbësit e ardhshëm të tyre dhe do të rezultojnë në një cikël tjetër protestash.

Opozita, gjithashtu, po bojkoton zgjedhjet vendore të Shqipërisë më 30 qershor dhe, si rezultat, në shumicën e bashkive ka vetëm një kandidat për postin e kryetarit. Socialistët, të cilët kanë mjaftueshëm vende në parlament për të drejtuar të vetëm, mbrojnë se nuk mund të shkelin kushtetutën duke ndryshuar ditën e zgjedhjeve. Ky qëndrim nuk ka gjasa të dobësojë demokratët, por thjesht do t'i bëjë ata edhe më radikalë dhe agresivë kundrejt institucioneve të shtetit.

Demonstratat e opozitës kundër qeverisë, që tashmë janë të dhunshme, priten të kenë edhe më shumë përplasje mes protestuesve dhe policisë. Udhëheqësit demokratë paralajmërojnë për përshkallëzime të mëtejshme (të dhunës), ndërsa dita e zgjedhjeve afron dhe protestuesit mund të përpiqen të ndalojnë vetë zhvillimin e votimeve. E nëse krerët politikë përgjegjës për këtë situatë nuk frenojnë zemërimin dhe arrijnë një

kompromis afatgjatë, Shqipëria mund të shkojë drejt një katastrofe të re.

Protestat në rrugë të Shqipërisë nuk janë si manifestimet ukrainase të tipit "Majdan", ku në vitin 2014 një lëvizje popullore, pluraliste, reformiste dhe pro-perëndimore rrëzoi një regjim pro-Moskë thellësisht të korruptuar dhe jo të dashur për popullin. Në rastin e Shqipërisë, protestat drejtohen nga partia kryesore opozitare, e cila parësisht synon të zëvendësojë qeverinë aktuale, pa eliminuar burimet dhe nxitësit e korrupsionit dhe klientelizmit.

Ciklet e bojkoteve, demonstratave dhe dhunës janë bërë të zakonshme në Shqipëri, duke dëmtuar thellësisht reputacionin e vendit gjatë dy dekadave të fundit. Për më tepër, ata mund të parandalojnë sërish fillimin e bisedimeve për pranimin e Shqipërisë në BE. Qeveritë në Francë dhe Holandë, të cilët kundërshtojnë zgjerimin e mëtejshëm të BE-së, do të përdorin dhunën dhe ndarjet politike si dëshmi për të thënë se Shqipëria nuk e ka vendin në Evropë.

Kaosi dhe dhuna në Shqipëri, gjithashtu, mund të ndikojë negativisht edhe në stabilitetin rajonal, duke shtyrë drejt tensioneve edhe politikanët dhe partitë shqiptare në vendet fqinje, sidomos në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Kjo mund të kontribuojë në

radikalizimin dhe madje polarizimin e politikës në këto dy shtete. Ekziston edhe skenari i kobshëm i përsëritjes të viti 1997, ku rënia e skemave piramidale rezultoi në mosfunksionimin e shtetit, ndërsa armët u vodhën nga arsenalet qeveritare dhe pjesëtarët e bandave të armatosura "bënin ligjin" në rrugë.

Rënia në kaos e një anëtarit të NATO-s dhe një aleati besnik të SHBA-së duhet të parandalohet nëpërmes një iniciative të fuqishme diplomatike që do t'i shtynte të dy palët drejt dialogut, do t'i kontrollonte militantët dhe do të zbutte tensionet. Për fat të keq, administrata e Donald Trumpit nuk i ka kushtuar shumë vëmendje Shqipërisë, duke u përqendruar kryesisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Maqedoni-Greqi dhe Kosovë-Serbi.

Po bëhet një vit që Shqipëria nuk ka ambasador të Shteteve të Bashkuara. Mungesa e një të dërguari të lartë dërgon mesazhe indiference dhe inkurajon radikalizmin politik. Shqiptarët e të gjitha ngjyrave politike e dinë se pa përfshirjen amerikane BE-ja është një lojtar i dobët politik në Ballkan. Shqipëria nuk mund të neglizhohet, nëse NATO është e vendosur të parandalojë paqëndrueshmërinë rajonale dhe të pengojë hapjen e një dere tjetër për ndërhyrjet subversive të Moskës.

(Marrë nga gazeta "Dita", Tiranë)

Shokët që (nuk) e duan Adem Jasharin



Shkruan: Sabit ISTOGU

Në prag të 20-vjetorit, Ditës së Çlirimit të Kosovës nga okupatori shekullor famëkeq serb, Prishtina pa shtatoren e heroit legjendar Adem Jasharit. Në kryeqytetin tonë, Prishtinën, janë ngritur disa shtatore të heronjve e të atyre që kontribuan për këtë

çlirim si shtatorja e Skënderbeut, e Zahir Pajazitit, e Ibrahim Rugovës, e Bill Klintonit e tash, siç mësova nga mediat, po u ngritka edhe një bust i të madhes Medlin Olbrajt, ish-sekretares së shtetit amerikan, e cila në ato vite bëri aq shumë që Kosova të jetë e lirë nga ky pushtues i egër. Madje në këtë vit jubilar, 20-vjetorin e pavarësisë, siç është njoftuar, do të vijnë edhe ish-presidenti i Amerikës, Bill Klinton, dhe ish-sekretarja e këtij shteti Olbrajt, dhe kjo sigurisht se është një nder që na bëhet, por nuk do ta kemi nderin që në kryeqytetin tonë, ende nuk

e ka gjetur rrugën të jetë edhe shtatorja e kryetritit, kryeheroit, më të merituarit për këtë liri, Adem Jasharit. Në sheshin me këtë emër në Prishtinë, "shokët" e tij, (nëse vërtet i kishte shokë), nuk e bënë as më të voglën përpjekje, që shtatorja e kryeheroit tonë ta zbkurojë këtë shesh, edhe pse shumica e këtyre "shokëve" mbajnë postet më të larta shtetërore, por nuk e ndiejnë përgjegjësin për këtë, duke menduar se ata vetë janë Adem Jashara.

Për ironinë më të madhe, shumë nga këta "shokë", pos në datat e kremteve historike, vijnë dhe vendosin lule te

varret e heronjve në Prekaz sa për t'i parë dikush dhe incizuar televizionet, madje edhe japin deklarata, gjithherë të njëjta e bajate, se ato Prekazin dhe sakrificën sublime të Adem Jasharit dhe Jasharëve të tjerë, do të kenë për herë frymëzim në rrugëtimin e tyre, por po del se kjo ishte dhe mbetet vetëm një demagogji e madhe e tyre. Ata, pra "shokët", nuk e vizitojnë edhe kullën e Jasharëve, sepse e kanë humbur fytyrën për ta vizituar e qëndruar në të, ngaqë ajo nuk duron të tillë. Edhe pa këta, kulla e Jasharëve është dhe do të mbetet e vizituar dhe e

frekuentuar gjithnjë nga qytetarët e mbarë vendit dhe trojet shqiptare, të atyre që heroizmin e të rënëve e kuptojnë si vlerë, e jo si mjet për t'u pasuruar.

Nuk e kam as më të voglin dyshim, se një ditë shtatorja e kryeheroit të Kosovës, Adem Jasharit, do të vendoset edhe në kryeqytetin tonë, duke ia shtuar madhësinë dhe krenarinë kryeqytetit dhe të gjithë qytetarëve, por sigurisht se jo nga "shokët" e tij, por nga ata që do të dinë t'i vlerësojnë vlerat e lirisë dhe ndërtimit të shtetit që e deshi Adem Jashari dhe gjithë heronjtë dhe populli ynë.

Hunt: BE-ja është e gatshme ta rinegociojë marrëveshjen e Brexitit

LONDËR, 9 QERSHOR - Sekretari i Jashtëm britanik, Jeremy Hunt, i cili është edhe kandidat për ta zëvendësuar Theresa May në postin e kryeministrit, tha të dielën se kancelarja gjermane, Angela Merkel kishite lënë të kuptohet se Bashkimi Evropian është i gatshëm të rinegociojë marrëveshjen e Brexit-it. Hunt tha se ka biseduar me Merklein gjatë përkujtimit të Betejës së Normandisë dhe tha se ndryshimi i marrëveshjes së

arritur nga May për daljen e Britanisë nga BE-ja, është i mundshëm. "Merkeli tha se natyrisht se me një kryeministër të ri të Britanisë, ne do ta shikojmë edhe njëherë çështjen dhe zgjidhjet që kryeministri do të ofrojë", tha Hunt. "Jam shumë i bindur se nëse kemi qasjen e duhur për këtë çështje, evropianët do të kenë vullnet që ta rinegociojmë marrëveshjen", tha ai. Britania vitin e kaluar ka arritur

një marrëveshje për daljen nga BE-ja, por Parlamenti britanik vazhdimisht e ka refuzuar atë. Ky shtet duhet të largohet nga BE-ja më 31 tetor të këtij viti, mirëpo paraprakisht Parlamenti duhet t'i miratojë kushtet e largimit. Vendimi për Brexit ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundrejt 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.



Marrëveshja e armatimit ndan ShBA-në dhe Turqinë

Në grindjen për furnizimin e planifikuar të Turqisë me raketa kundërajrore ruse, ShBA-ja po rrit presionin ndaj partnerit të NATO-s, duke kërcënuar Turqinë me përjashtimin nga programi i avionëve luftarakë F35

WASHINGTON, 9 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë vënë Turqisë një afat deri në fund të korrikut, për të hequr dorë nga blerja e sistemit me raketa kundërajrore ruse, S-400. Në të njëjtën kohë, Pentagoni ka bërë të ditur, se do të vendosë sanksione, nëse qeveria në Ankara, nuk e përmbush këtë kërkesë. Në rast nevojë të gjithë pilotët turq, që aktualisht trajnohen për përdorimin e avionëve luftarakë të NATO-s, F35 do të largohen nga ShBA-ja, paralajmëron Pentagoni. Përveç kësaj do

të mbyllet për firmat nga Turqia rruga e pjesëmarrjes në konstruktimin e avionëve F35. Ministri amerikan i Mbrojtjes në detyrë, Patrick Shanahan tha para gazetarëve, se ai e ka informuar me shkrim, homologun turk, Hulusi Akar. Turqia nuk ka për të marrë as avionë F35, nëse nuk ndërton kurs, theksoi Shanahan. Qeveria turke ka porositur qindra avionë të tipit F35 që prodhohen nga koncerni amerikan, Lockheed Martin. ShBA-ja dhe anëtarë të tjerë të



NATO-s frikësohen, se Rusia përmes sistemit S-400 do mund të marrë informacione për avionët e aleancës perëndimore. Uashingtoni preferon që Ankaraja në vend të raketave ruse, të marrë sistemin amerikan, Patriot, ka njoftuar dw.

Presidenti turk, Taip Erdogan këmbëngul në marrëveshjen me Rusinë. Qeveria e tij nuk ka ndër mend të "tërhiqet", deklaroi Erdogani në javën që përfundoi. Moskua i ka bërë vendit të tij një ofertë më të mirë, argumentoi ai. Raketat e para kundërajrore ruse pritet të dërgohen në dy muajt e ardhshëm, bëri të ditur, kreu i koncernit shtetëror rus të armatimit, Rostec, Sergej Tshemesov. Ai tha se me Turqinë gjithçka po ecën në rrugën e duhur.

Liderja e CDU-së kundërshton mundësinë e lehtësimit të sanksioneve ndaj Ruisë

BERLIN, 9 QERSHOR - Liderja e partisë së kancelares gjermane, Angela Merkel, Unioni Demokratian (CDU), ka refuzuar thirrjet e bashkëpartiakëve të saj, për të lehtësuar sanksionet ndaj Ruisë, duke thënë se ato do të vazhdojnë të jenë në fuqi derisa të ndryshojë sjellja e Moskës në Krimë dhe lindje të Ukrainës. Annegret Kramp-Karrenbauer tha se "përderisa nuk ka ndryshim në sjelljen e Ruisë, nuk do të ketë hapësirë për ndryshime në bashkëpunimin ekonomik". Komentet e saj janë kundërshtim me bashkëpartiakun e saj, Michael Kretschmer,



që është guvernator i shtetit gjerman të Saksonisë. Kretschmer ishte takuar me presidentin rus, Vladimir Putin në Forumin Ekonomik të mbajtur më 7 qershor në Shën Petersburg, dhe më vonë kishte shkruar në "Twitter" se "ne na duhen marrëdhënie më të mira, na duhet t'u japim fund sanksioneve". BE-ja dhe ShBA-ja kanë vendosur sanksione ekonomike ndaj Moskës, që prej se më 2014 aneksoi gadishullin ukrainas të Krimesë. Po ashtu Moska mbështet separatistët në luftën e tyre kundër forcave qeveritare

ukrainase, në lindje të Ukrainës. Në një intervistë për të përditshmen gjermane Bild, Kramp-Karrenbauer, e cila është pasardhëse e Merkelit në CDU, tha se Moskua fillimisht duhet të tërhiqet nga ndërhyrja në Ukrainë, para se mundësia e lehtësimit të sanksioneve të mund të shqyrtohet. "Sanksionet ekonomike janë reagim ndaj shkeljeve të Qeverisë ruse të ligjeve ndërkombëtare në Krimë dhe lindje të Ukrainës. Derisa asgjë të mos ndryshojë në sjelljen e Ruisë, nuk ka hapësirë për ndryshimin e bashkëpunimit ekonomik", tha udhëheqësja e CDU-së.

Shpërbëhet Parlamenti i Moldavisë

KISHINIEV, 9 QERSHOR - Presidenti në detyrë i Moldavisë, Pavel Filip ka shpërbërë Parlamentin dhe ka thirrur zgjedhje të jashtëzakonshme të mbahen më 6 shtator, teksa shteti i ish-Bashkimit Sovjetik po përballet me një krizë të madhe politike. Filip njoftoi për këtë vendim të dielën, vetëm pak kohë pasi Gjykata Kushtetuese e rrëzoi

nga pushteti presidentin pro-rus, Igor Dodon dhe e emëroi Filip - i cili është kryeministër në detyrë - si president në detyrë. Qindra persona dolën në rrugët e kryeqytetit moldav, Kishiniev që prej 8 qershorit, për të protestuar kundër Dodon dhe për të mbështetur vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Protesta

është organizuar nga Partia Demokratike, që udhëhiqet nga Vlad Plahotniuc, që është personi më i pasur në Moldavi. Njoftimi i presidentit në detyrë, Filip, vjen vetëm një ditë pasi liderët parlamentarë u takuan në një seancë të jashtëzakonshme, duke tentuar që të formojnë Qeverinë, pas zgjedhjeve të mbajtura në shkurt.



Në Sundern të Gjermanisë u promovua "Libri i luftës"

Nuhi Bytyçi: Ne e fituam luftën, ne duhet të sillemi fitimtarë dhe të kemi përgjegjësi për ndërtimin e shtetit

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Me shfaqjen e xhirimeve dokumentare nga ngjarjet historike në Kosovë, në Kosovën Lindore, në Maqedoninë Veriore, në Mal të Zi, në Shqipëri, në diasporën shqiptare e deri te shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe formimi i Ushtrisë së Kosovës, të cilat paraqesin veprimtarinë profesionale të gazetarit e publicistit Nuhi Bytyçi gjatë periudhës së kaluar më se 40-vjeçare, në Sundern të Gjermanisë filloi promovimi i "Librit të luftës" të këtij autori.

Organizator i këtij eventi ishte Kryesia e Klubit të Shqiptarëve "2 korriku" në këtë qytezë të bukur të Sauerlandit. Kryetari i këtij klubi, Fadil Bytyçi, duke përshëndetur pjesëmarrësit, ka thënë se promovimi i "Librit të luftës" po bëhet me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës dhe e çmoi këtë një dhuratë të çmueshme për bashkatdhetarët tanë.

Në fjalën e rastit veprimtari i çështjes kombëtare, ish-luftëtari i lirisë, gazetari e shkrimtari Martin Çuni, ka vlerësuar gjithanshëm kontributin e vazhdueshëm të autorit të librit, gazetarit e publicistit Nuhi Bytyçi gjatë periudhës më se 40-vjeçare përherë në shërbim të informimit të publikut dhe të interesave kombëtare.

Nuhi Bytyçi, si gazetar, me nuxhimin e tij intelektual ishte pjesë e rezistencës kombëtare edhe në kohën e tubimeve gjithëpopullore kundër suprimimit të autonomisë së Kosovës, edhe në Grevën e Minatorëve të "Trepçës" në vitin 1989. Ai ishte në këtë rol edhe më 2 korrik 1990, në ditën e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese për Kosovën Republikë. Në epokën e rezistencës së viteve nëntëdhjeta, gazetari Nuhi Bytyçi me profesionalizëm kreu detyrën e gazetarit, duke afirmuar organizimin e sistemit të pavarur të Republikës së Kosovës në fushën e arsimit, të shëndetësisë dhe të financimit të institucioneve të Republikës së Kosovës, përkujtoi Martin Çuni. Ai pohoi se përmes emisioneve të tij televizive, të transmetuara në Programin Satelitor të Televizionit Shqiptar, Bytyçi ishte në krah të rezistencës gjithëpopullore të Kosovës për liri dhe pavarësi.

Në vitin 1997 Nuhi Bytyçi, bashkë me Qani Mehmedin, me vetëiniciativën e tyre realizojnë emision televiziv me liderët e Lëvizjes Studentore, duke u vënë në mbështetje të hapur të organizimit të demonstratave studentore të 1 tetorit 1997. Ndërkaq, me



fillimin e hovshëm të luftës çlirimtare, në vitin 1998 Nuhi Bytyçi bëhet pjesë e kësaj lufte, duke raportuar dhe duke realizuar emisione televizive për rezistencën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që nga Dukagjini deri te Drenica, Llapusha, Anadriina, Llapi, Shala dhe Neredimja. Nuhi Bytyçi bashkë me kameramanin Abaz Zeka ishin të parët që xhiruan dhe transmetuan në Televizionin Shqiptar dhe në mediat botërore paraqitjen e parë publike të zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të Betimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të shumë emisioneve për UÇK-në dhe territoret e lira, për mbijetesën e popullatës civile, për radion e luftës, Radion "Kosova e Lirë" dhe agjencinë e lajmeve "Kosovapress", madje edhe për organizimin e funksionimit të sistemit shëndetësor dhe arsimor edhe në territoret e lira të kontrolluara nga UÇK-ja, theksoi publicisti e intelektual Martin Çuni.

Çuni me këtë rast ka thënë se Nuhiun e Abazin e kam takuar në zonat e luftës në Drenicë dhe ka pasur një bashkëpunim korrekt gjatë dhe pas luftës.

Bytyçi ka realizuar mbi 100 dokumentarë për luftën dhe dëshmorët e lirisë, ishte aty edhe kur u shpall pavarësia e Kosovës më 17 shkurt 2008.

Çuni ka pohuar se të gjitha këto zhvillime dinamike politike dhe kombëtare të viteve tetëdhjeta,

nëntëdhjeta e deri më sot, të përjetuara drejtpërdrejt nga gazetari Nuhi Bytyçi, të shikuara nga këndvështrimi i tij i pavarur, janë pjesë e memoareve të tij, të prezantuara në "Librin e luftës", të botuar nga Shtëpia Botuese "Armagedoni" dhe mbështetur nga Ministria e Kulturës dhe afaristi ynë i mirënjohur Lazim Destani.

Lidhur me veprimtarinë gazetareske e atdhetare të Nuhi Bytyçit folën edhe veprimtari i çështjes kombëtare në Gjermani, ish-luftëtari i UÇK-së e afaristi i suksesshëm Gani Nuha, veprimtari e humanisti Avdi Fejza, veprimtari e afaristi i dalluar Bekim Bytyçi, veprimtarët nga Llapusha Alush Kryeziu, Hajrullah Morina, Rrustem Bajraj, pastaj Nazmi Muçaj, Xhevdet Hajdaraj e të tjerë, të cilët botimin e "Librit të luftës" e vlerësuan një vepër enciklopedike historike me interes të jashtëzakonshëm për lexuesit.

Duke falënderuar pjesëmarrësit e këtij promovimi për këto vlerësime, autori i librit, Nuhi Bytyçi, i informoi ata pse e ka titulluar veprën e tij jetësore "Libri i luftës": "E kam titulluar kështu, sepse periudha më se 40-vjeçare e popullit tim, pra edhe e inja si gazetar, intelektual dhe veprimtar, ka qenë vërtet luftë. Ka qenë luftë për dinjitet kombëtar, luftë për thyerjen e censurës komuniste në Televizionin e Prishtinës,

luftë për të vërtetën për Kosovën dhe shqiptarët, luftë për mposhtjen e frikës dhe dinamizimin e lëvizjes për liri, luftë mediatike për ta pasqyruar luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të luftës për të ardhmen e Kosovës Lindore, luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare për të drejtën të plota kombëtare të shqiptarëve në Iliridë, libër i luftës për pavarësinë dhe ndërtimin e shtetit demokratik dhe perspektivën evropiane të Kosovës", ka thënë Bytyçi, duke shtuar se: "Përmes ngjarjeve që bëjnë historinë më të re kombëtare, të përfshira në librin tim, kam dashur që para opinionit lexues shqiptar, por edhe atij botëror, të jap disa mesazhe të fuqishme: Me gjithë faktin se kur një popull i pushtuar, një popull i nëpërkëmbur, një popull i terrorizuar deri në gjenocid nga aparati i dhunës shtetërore serbo-sllave, atëherë kur shqiptarët e Kosovës kanë vendosur t'i kundërshtojnë fuqishëm dhe t'i mposhtin të gjitha këto me organizimin dhe mobilizimin e përgjithshëm nën flamurin e luftës për liri, arritën që të kenë përkrahjen e botës demokratike, sidomos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera anëtare të NATO-s. Dhe kështu, pas gjakut të derdhur të mijëra dëshmorëve dhe martirëve, populli shqiptar i Kosovës fitoi luftën, doli fitimtar në raport

me forcat shumëfish më të mëdha ushtarake e policore serbe.

Mbështetur nga miqtë tanë strategjikë perëndimorë, populli ynë është fitimtar dhe për këtë duhet të jetë krenar. Prandaj, ne duhet të jemi krenarë që jemi fitimtarë ndaj një regjimi gjenocidal në Ballkan", ka përkujtuar Nuhi Bytyçi.

Nuhi Bytyçi zhvilloi një bashkëbisedim me pjesëmarrësit e promovimit. Ai e vlerësoi shumë të madh kontributin e diasporës shqiptare gjatë periudhës së okupimit serb, e veçmas gjatë periudhës së luftës për liri e pavarësi të Kosovës. Duke u përgjigjur në pyetjen se cilat janë projektet e tij të reja në të ardhmen, Bytyçi ka thënë se: "Kam në plan të realizoj një varg projektesh të reja dokumentare, por ai më i riu është realizimi i filmit dokumentar kushtuar luftëtarëve të UÇK-së dhe dëshmorëve të vendlindjes së tij - Shkozës së Malishevës, për realizimin e tij në mënyrë profesionale, përveç mbështetjes nga Ministria e Kulturës pret edhe mbështetjen e bashkëvendësve të tij në Gjermani, Holandë, Zvicër e Amerikë".

Me rastin e promovimit të "Librit të luftës", autori Nuhi Bytyçi me disa nga pjesëmarrësit e promovimit vizituan Shtatoren e Nënës së madhe shqiptare, Terezës, në Sundern.

E rrallë

Krijohen arinjtë e rremë polarë

Duken tepër realiste, por janë vetëm kopje. Një kompani ka krijuar arinj të rremë polarë për të mbledhur fonde për ruajtjen e kafshëve të egra. Është një alternativë ndaj taksimit, një teknikë për përgatitjen dhe ruajtjen e trupave të kafshëve. Çdo ari kërkon tre muaj për përpunim dhe çmimi është mbi 70 mijë euro për ariun e rritur dhe pothuajse 110 mijë euro për të rriturit dhe konen e tij, i cili nuk është i disponueshëm veçmas. Arinjtë janë të mbështjellë me plush të një cilësie të lartë.



FOTO E DITES




Nxënësit në një rajon të Filipinës kanë përdorur styropoll për ta shndërruar në barkë pas vërshimeve në këtë vend për të shkuar në shkollë /AFP/

E jashtëzakonshme

Avioni "V" do të testohet këtë tetor

Avioni "V" nuk është thjesht një projekt 3D, por një prototip që do të vihet në provë gjatë këtij viti. Koncepti është zhvilluar në Delft Technology University të Holandës dhe financohet nga KLM. E veçanta e këtij avioni, i cili i hap krahët po aq sa të tjerët, është se udhëtarët do të ulen pikërisht të krahët. Avioni do t'i mbajë rreth 314 udhëtarë të



krahët, hapësirë që tani qëndron bosh dhe pritet të konsumojë 20 për qind më pak karburant.

BARSOLETA E DITËS



POLICI DHE KOMANDANTI

- Polici: Erdhëm këtu te shtëpia ku na sinjalizuat. Zona e shtëpisë thotë se ka vrrarë burrin se kishte shkelur me këpucë në parketin sapo e kishte pastruar.
- Komandanti: E arrestuat?
- Polici: Jo akoma, se parketi nuk është tharë ende.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Nuk keni mundur t'u jepni përgjigje dyshimeve të shumë personave sot. Nëse e lini të kalojë këtë situatë, gjërat thjesht do të mbeten pa sqaruar.</p>	 <p>DEMI Sot jeni në fushë të hapur me kundërshtarët tuaj. Duhet të keni kujdes nga ata që ende nuk janë shfaqur përballë jush.</p>	 <p>BINJAKËT Do ta keni të vështirë t'i keni nën vëzhgim personat me të cilët keni marrëdhënie pune. Shumë prej tyre janë të prirë të neglizhojnë.</p>	 <p>GAFORRJA Nuk mund të gënjeni sot ata persona që rrinë pranë jush. Edhe pse po tentoni t'i fshihni ndjenjat tuaja dikush do të zbulojë çfarë ju shqetëson.</p>	 <p>LUANI Edhe pse nuk po e pranoni, keni nevojë të keni pranë vetes një person të caktuar që dashur padashur jua ndryshon humorin dhe jua kthen buzëqeshjen.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Mungesa e besimit ju ka bërë më të ftohtë në marrëdhënie me të tjerët. Jo me të gjithë mund të mbani të njëjtin qëndrim indiferent.</p>
 <p>PESHORJA Tregohuni më të hapur me të tjerët dhe ata do të bëjnë çmos t'ju tregojnë mirënjohje. Zgjidhni personat që besoni në rrugën tuaj.</p>	 <p>AKREPI Duhet ta vini veten në vend të dikujt tjetër që të mund të gjykoni një situatë të caktuar. Jo gjithmonë gjërat janë ashtu siç duken.</p>	 <p>SHIGJETARI Problemet tuaja zgjidhni përpara se të jetë shumë vonë. Dikush do të luajë një lojë të pistë nga e cila do të dilni jo pak të lënduar.</p>	 <p>BRICJAPI Të konkretizoni atë që keni në mendje sot nuk do të jetë shumë e vështirë. Mjaft të flisni me njerëzit e duhur dhe gjërat do të realizohen.</p>	 <p>UJORI Sot mos kaloni në sulm kur t'ju pyesin për gjëra shumë të thjeshta. Nervozizmi juaj do të lërë të kuptohet që ka diçka që nuk shkon.</p>	 <p>PESHQIT Do t'ju lindin disa probleme në fushën profesionale sot që do të duhet medeoemos t'i zgjidhni. Jeni në udhëkryq dhe po tentoni ta gjeni drejtimin.</p>

Maryl Streep thotë se aktrimi ka qenë një terapi për të



Aktorja e njohur Maryl Streep ka thënë se aktrimi e ka bërë si grua më të fortë. Këtë e tha në një intervistë për gazetën "The Sydney Morning Herald". "Unë gjithmonë e kam parë që aktrimi më ka dhënë më shumë vetëbesim, pasi unë si një vajzë e re në këtë fushë jam ndjerë

sikur që njerëzit nuk më kanë besuar se di të luaj", ka thënë ajo. Streep ka theksuar se sa më shumë që aktronte aq më mirë ndihej. "Aktrimi çdoherë ka qenë një terapi e mirë për mua sepse sa më shumë role që kisha aq më shumë kuptoja diçka për veten time", ka deklaruar Streep.

Malika Haqq konfirmon ndarjen nga i dashuri



Malika Haqq është sërish beqare. 36-vjeçarja konfirmoi përmes "Instagram"-it se ajo dhe i dashuri i saj O. T. Genasis janë ndarë. "Beqare, ka shkruar ajo

poshtë një fotografie të postuar. Malika dhe reperi 31-vjeçar kanë qenë në lidhje që nga viti 2017, vetëm disa muaj pasi ajo dhe ish i dashuri u ndanë.



Rihanna kthehet nga pushimet romantike me të dashurin

Rihanna është fotografuar në aeroport pas arritjes në Nju Jork. Këngëtarja 31-vjeçare u kthye në Nju Jork pas një udhëtimi romantik në Itali me të dashurin e saj

Hassan Jameel. Kohët e fundit Rihanna u emërua këngëtarja më e pasur femër në botë falë suksesit të saj masiv me linjën e kozmetikës Fenty Beauty dhe atë të modës.

Martohen Chris Pratt dhe Katherine Schwarzenegge



Aktori i njohur Chris Pratt është martuar me të dashurën e tij Katherine Schwarzenegge, këtë fundjavë. Lajmin e ka bërë me dije një burim i afërt i çiftit për "People". Çifti, i

cili janë bashkë nga vera e vitit 2018, u martuan në Kaliforni në praninë e familjarëve dhe miqve të tyre. Ky burim për "People" ka njoftuar se çifti ishin shumë të lumtur bashkë me të ftuarit.

Si të shpëtoni nga zhurma dhe ndotja e kryeqytetit? Mrekullia gjendet në mes të Malit të Dajtit

Zhurma dhe ndotja janë shndërruar në një stres të vërtetë për qytetarët e Tiranës. Por ka një vend ku mund të shpëtoni nga të gjithë këto. Vetëm pak kilometra larg qendrës së kryeqytetit ndodhet Mali i Dajtit, një bukurri përballore, ku mund të shijoni ajrin e pastër, bimësinë, lokalet me pamje piktoreske dhe sigurisht gatimet tradicionale.

Parku Kombëtar i Dajtit është mali më i afërt me qytetin, vetëm 25 km në lindje të Tiranës. Një udhëtim atje, është një ndër aktivitetet më të preferuara turistike në Tiranë. Duhet 20 minuta me makinë nga qendra e Tiranës deri te stacioni i Teleferikut.

Ky udhëtim drejt këtij vendi magjik bëhet edhe më i lehtë nëse zgjidhni të shkoni me Teleferik. "Dajti Ekspres" ofron një udhëtim të paharruar mes maleve dhe në vetëm pak minuta, do e gjeni veten në majën e Tiranës.

"Dajti Ekspres" është një vepër tepër unike, pasi është i pari investim i këtij lloji në fushën e turizmit, të rekreacionit, të mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

E ndërsa udhëtoni në

komoditetin maksimal që ofron teleferiku, mund të relaksoheni teksa shihni pamjet mahnitëse të një prej shumë mrekullive që ka vendi ynë. Për 13 minutash udhëtim ju mund të ngjiteni në majën e malit nga ku u ofrohet një pamje panoramike e qytetit, fshatra, pyje, bunkerë, shtëpi dhe gjithë rrethinat.

Udhëtimi mbaron sa hap e mbyll sytë dhe më pas ju do shijoni parajsën në tokë, Parkun Kombëtar të Dajtit.

Por magjia e vërtetë sapo ka nisur. Gjithë këtë mrekulli ju mund ta soditni duke provuar gatimet tradicionale që ofron restoranti "Ballkoni i Dajtit". Ushqim i shijshëm dhe një vend me pamje mahnitëse. Kështu mund të përshkruhet vetëm me pak fjalë restoranti "Ballkoni i Dajtit".

I gjendur mes maleve, por edhe me pamje madhështore nga Tirana, ky restorant ofron gatimet më të mira shqiptare dhe mesdhetare me një shërbim të shkëlqyer.

Ai është një vend mjaft i këndshëm dhe i rehatshëm, me hapësira të bollshme, nga ku të ofrohet një pamje e plotë e krye-



qytetit. Restoranti është elegant, modern, argëtues dhe mjaft mikpritës për klientët.

Parku Kombëtar i Dajtit frekuentohet nga shumë vizitorë ditorë, ndërsa ofron mundësi akomodimi edhe për turistët e huaj. Ai është një vend perfekt për t'u relaksuar dhe për të thithur ajër

të pastër dhe larg zhurmave të Tiranës.

Ky park është atraktiv gjatë gjithë stinëve, por kryesisht në verë për freskinë që ofron dhe në dimër kur mali mbulohet nga bora.

Aventurat nuk kanë fund në Dajti dhe gjithçka bëhet më e lehtë dhe e bukur nëse zgjidhni mënyrën e

duhur për të udhëtuar dhe vendin e përshtatshëm për të ngrënë mirë. Ndaj nëse jeni në Tiranë, mos humbni rastin të shkoni te "Ballkoni i Dajtit", sigurisht duke zgjedhur mënyrën më të mirë për të udhëtuar, Teleferikun.

Gazeta Shqip

Një sekret 700-vjeçar në Jerusalem



I fshehur poshtë rrugëve të Jerusalemit, një hamam i lashtë është duke dalë në dritë. Pasi qëndroi jashtë përdorimi që nga viti 1970 hamami i quajtur al-Ayn, i ndërtuar në shekullin e 14 së bashku me sheshin Khan Tankiz mbi të dhe hamamin

al-Shifa pranë, i është nënshtruar një restaurimi të gjerë.

Dhe këtë verë, hamami 700-vjeçar do të rivijë në jetë me punë të plotë, duke u ofruar vizitorëve mundësinë për t'u kënaqur në banjat me avull dhe trajtime të tjera spa.

E ndërtuar rreth vitit 1336, kjo banjë fillimisht u shërbeu pelegrinëve myslimanë, të cilët dëshironin t'i nënshtroheshin ritualit të larjes përpara namazit në xhaminë më të afërt të al-Aksa, bashkë me tregtarët dhe banorët lokalë, të cilët thjesht laheshin këtu

për qëllime higjienike. Por sapo çezmat u bënë të zakonshëm në shtëpitë lokale rreth një shekull më parë, më pak njerëz erdhën për t'u larë në hamam dhe ato erdhën duke u reduktuar nga mesi i shekullit të 20-të.

Përveç disa hoteleve të Jerusalemit që përfshijnë banjat moderne, si pjesë e komplekseve të tyre spa, hamami i restauruar al-Ayn është shndërruar në një galeri të vërtetë arti për turistët.



Njihuni me burrat fotografë të Jugut të Shqipërisë

Një ekspozitë e kuruar nga Gjergj Spathari do të sjellë një histori të fotografëve që vijnë nga juglindja shqiptare. Imazhe që të çojnë në Shqipërinë e një shekulli më parë vijnë përmes emrave që janë shumë pak të njohur, megjithëse kanë një kontribut të çmuar. Ekspozita hapet më 7 qershor në Muzeun e Fotografisë Marubi. Janë tetë autorë që përcjellin momente nga jeta politiko-shoqërore e juglindjes së Shqipërisë. Kristo Sulidhi (1858 – 1938) / Perikli Kaçauni (1870 – 1940) / Dhimitër Vangjeli (1872 – 1957) / Vani Burda (1875 – 1949) / Kristaq Sotiri (1883 – 1970) / Petro Dhimitri (1886 – 1953) / Thimi Raci (1886 – 1966) / Mandi Adham Koçi (1912 – 1988). Më poshtë po japim detaje nga jeta e secilit prej tyre.

Thimi RACI (Dardhë, 1886 – Dardhë, 1966)

15 vjeç emigroi në Rumani, nga ku u kthye pas 7 vjetësh. Mjeshtërinë e fotografit e mësoi nga Pero Kaçauni, i cili emigroi në Amerikë në vitin 1910 dhe i la Thimit të gjitha pajisjet e fotografimit. Një vit më vonë, në Dardhë kishte një dyqan me tabelën "Thimi Ratsi – teneqexhi dhe fotograf".

Ka fiksuar kryesisht portrete familjesh, fëmijë, dasma dhe foto të ngjarjeve të fshatit, shkolla, manifestime e peizazhe. Banorët nga krahinat e Devollit dhe fushës së Korçës, fotofoheshin në studion e Racit. Foto të tija janë ekspozuar në Shqipëri dhe në Amerikë. Në AQSH, në Tiranë ndodhen rreth 2000 negativë, dhuruar nga i biri, Andrea. Para vdekjes Thimi Raci, i dhuroi Muzeut Historik në Tiranë, aparatet e veta fotografike.



Petro DHIMITRI (Korçë, 1886 – Korçë, 1953)

Rreth vitit 1890, emigron në Stamboll, ku përveç punëve të ndryshme, mësoi zanatin e fotografit. I njohur gjerësisht si Petro Fotografi ishte në qendër të aktivitetit fotografik në terrenin patriotik të jugut, por edhe deri në veri, para dhe pas 1912-ës. Emri i tij është i lidhur me Çerçiz Topullin, Mihal Gramenon, Mitingun e Shkronjave Shqipe, Kuvendin Kombëtar të Vlorës, Shpalljen e Pavarësisë, etj. Fatkeqësisht pasardhësit e tij nuk

mundën të kujdeseshin për trashëgiminë që la dhe fototeka e tij është dëmtuar shumë, duke bërë që sot të jenë në gjendje studimi një numër i paktë i fotografive të tij, përveç atyre të botuara në shtypin e kohës apo në kartolina. Shkatërrimi i studios dhe fototekës së tij, nuk na lejon të kuptojmë më shumë. Logot e përdorura në fotografitë e tij përmbajnë shkrimet: "Petro Fotografi Korçë", "Petro Fotografi", "PD.", etj. Në fund të viteve '20 të shekullit të kaluar, shtypi shqiptar në Rumani bënte thirrje për të ndih-

muar financiarisht fotografimin patriot, që mesa duket jetonte në mjerim.

Dhimitër VANGJELI

Emigroi në moshë të re, nga fshati në Athinë ku punoi e mësoi disa profesione. Kur u kthye hapi një dyqan të vogël në Ersekë në tabelën e të cilit shkruhej "Hëmbëltore, Orëndreqës dhe Fotografia". Me pasionin e fotografit, Vangjeli me aparatit fotografik, shëtiti në fshatrat e Kolonjës duke vënë në fokus të gjitha ciklet e jetës: lindjet, pagëzimet, martesat dhe ceremonitë mortore. Fotot e tij pasqyrojnë realitetin e Kolonjës në gjysmën e parë të shek. XX. Pas vdekjes askush nuk u kujdes për punën e tij, një pjesë e së cilës mbeti e mbyllur për 60 vjet në një arkë të papërshtatshme nga ku e shpëtuan rastësisht një grup i vogël njerëzish. Afërsisht 1300 negativë në xham të këtij fondi kanë mundur t'i shpëtojnë kohës.

Kristo SULIDHI (Marjan, Opar, 1858 – Korçë, 1938)

Është i pari dhe më i vjetri fotograf i dokumentuar i qytetit të Korçës. Që i ri emigroi në Greqi, ku falë edhe talentit të tij mësoi mjeshtërinë e fotografit. Në fillim të viteve '80, të shek. XIX punoi në Korçë si fotograf. Fotografia më e vjetër, e njohur nga Sulidhi është e vitit 1890. Ishte shumë aktiv në lëvizjet patriotike të kohës, gjë që e reflekton edhe në fotografi. Ndër të tjera fiksoi në celiloid dy momente që historia jonë do t'i mbajë mend shumë gjatë: Mësonjëtorën e Parë Shqipe të djemve dhe Mësonjëtorën e Parë



Shqipe të vashave. Të vitit 1908 janë disa momente nga festimi i shpalljes së Kushtetutës xhonturke. Këtë fotografi ai e stampon me vulën "Ch.P.Soulides".

Kristaq SOTIRI (Mborje, 1883 – Korçë, 1970)

Në moshën 17 vjeçare merr mësimet e para të fotografisë tek kunati i tij, Kristo Sulidhi. Nga fillimi i shek. XX emigroi në Sh.B.A., ku për vite me radhë studioi fotografi dhe punoi në studion e mjeshtrit George Steckel. Rreth vitit 1923 kthehet në Korçë dhe hap "Sotir Studio", fondalet dhe brenditë e së cilës i realizoi miku i tij, piktori Vangjush Mio. Nga Sotiri sot trashëgohen rreth 14.000 negativë dhe 1.700 stampime origjinale, që përbëjnë bazën e gjithë punës së mjeshtrit, kryesisht portrete dhe peizazhe që nuk largohen përtej Korçës, rrethinave dhe fshatrave të saj.

Vani BURDA (Korçë, 1875 – Korçë, 1949)

Në moshë të re, Burda shkoi në Rumani, Bukuresht, në Egjipt dhe për një kohë të shkurtër në Stamboll. Në Rumani hapi atelienë e vet fotografike duke qenë shumë aktiv në koloninë shqiptare të atjeshme. Me grupin e delegatëve të kolonisë shkoi në Vlorë me rastin e Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare. Më 1920, u kthye në Korçë, ku hapi studion e vet fotografike. Fondi i këtij fotografi gjendet i shpërndarë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe në koleksione private. Vdiq në mjerim ekonomik... cigareshitës në një kioskë në qendër të qytetit.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045 82 82 82

Nderohet legjenda

Legjenda Fadil Vokri është kujtuar dhe nderuar me rastin e njëvjetorit të shkuarjes në amshim. Pasardhësi i Vokrit në Federatën e Futbollit, Agim Ademi, ka thënë se legjenda ishte njeriu kryesor që Kosova është e barabartë me shtetet e tjera në futboll. "Sot një vit mbetëm pa një futbollist e mik të pazëvendësueshëm. Ne në FFK mbetëm pa prijësin tonë, i cili ishte kreator i rrugës drejt UEFA-s dhe FIFA-s dhe do të mbetet në histori si njeriu që e dërgoi Kosovën atje ku janë të gjitha shtetet, si pjesë e barabartë e familjes evropiane dhe botërore të futbollit modern", ka thënë Ademi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Legjenda e futbollit të Kosovës dhe kryetari historik i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokri, është kujtuar me rastin e njëvjetorit të vdekjes së tij. Emblema e të gjithë shqiptarëve është nderuar dhe kujtuar nga bashkëpunëtorët e tij, qytetarë, sportistë dhe politikanë. Kryetari aktual i Federatës së Futbollit, Agim Ademi, së bashku me anëtarët e tjerë të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, sekretarin e përgjithshëm, Eroll Salihu, punëtorët e administratës së FFK-së, ish-futbollistët e njohur, gjyqtarët dhe trajnerët si dhe grupin e tifozëve "Dardanët", e kanë zbuluar pllakën përkujtimore te varri i



"Në këtë përvjetor jemi mbledhur për të bërë homazhe dhe për ta zbuluar pllakën përkujtimore te varri i tij, që është bërë nga Federata e Futbollit të Kosovës dhe për t'i evokuar kujtimet për legjendën. Ne i jemi përherë mirënjohës atij, por edhe të gjithë atyre që sot nuk janë në mesin tonë e që kanë kontribuar ndër vite të vijmë deri në këtë ditë, sepse futbollit është sport kolektiv dhe gjithmonë ka nevojë të funksionojë si ekip. Kështu kemi punuar edhe në kohën e Fadil Vokrit, i cili si

kapiten na ka prirë në rrugën e suksesit si Federatë. Edhe tani me ekip të përbashkët po e çojmë FFK-në dhe futbollin e Kosovës në një stad tjetër, duke arritur rezultate kulmore. Dhimbjen që e kemi përjetuar me humbjen e kryetarit Vokri tani e kemi shndërruar në përgjegjësi dhe krenari për sukseset e tjera. I qoftë i lehtë dhe i Kosovës, legjendës Fadil Vokri!", ka deklaruar Ademi. Legjenda Fadil Vokri është kujtuar edhe nga djali i tij, Gramozi. Ky i fundit në "Instagram" ka

shkarkuar: "Vdekja nuk është humbja më e madhe në jetë. Humbja më e madhe në jetë është ajo që vdes brenda nesh derisa ne jetojmë. Ama, gjithmonë ekziston një arsyeje për të buzëqeshur deri në fund...". Përfaqësuesja e Kosovës të dielën e ka nderuar me një koreografi simbolike dhe me një minutë heshtje ish-kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrin, në Sofje, atje ku do ta zhvillojë sot (e hënën) ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2020" ndaj Bullgarisë. "Jemi mbledhur këtu për ta nderuar mikun dhe udhëheqësin tonë, Fadil Vokri. Ky vit më ka shkuar më ngadalë se 40 vjet që jam shoqëruar së bashku me të. Të gjithë kemi çfarë të kujtojmë e përmendim. Të gjithë që e kanë njohur e dinë sa i madh ka qenë dhe i madh ka mbetur. Do të kisha dëshiruar që rrugëtimi i tij të vazhdohet dhe fjalët e tij t'i nderojmë e respektojmë", ka thënë nënkryetari i FFK-së, Bakir Burri.



legjendës dhe kanë bërë homazhe. Kryetari Ademi me këtë rast vlerësoi se Fadil Vokri ishte kreator i rrugëtimin të Kosovës drejt anëtarësimit në UEFA dhe FIFA. "Sot një vit mbetëm pa një futbollist e mik të pazëvendësueshëm. Ne në FFK mbetëm pa prijësin tonë, i cili ishte kreator i rrugës drejt UEFA-s dhe FIFA-s dhe do të mbetet në histori si njeriu që e dërgoi Kosovën atje ku janë të gjitha shtetet, si pjesë e barabartë e familjes evropiane dhe botërore të futbollit modern", ka thënë Ademi.

Veseli: I përjetshëm kujtimi për Fadil Vokrin

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i PDK-së, Kadri Veseli, ka bërë homazhe te varri i legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokri, në njëvjetorin e vdekjes së tij. Veseli ka shkruar në faqen e vet në "Facebook" se i përjetshëm do të jetë kujtimi për Fadil Vokrin. "I përjetshëm kujtimi për ty, Fadil Vokri! Ëndrrat dhe vizioni yt do të jenë pjesë e punës dhe përkushtimit tonë të përditshëm, si dhe motiv frymëzues për sukseset e gjeneratave të reja", ka shkruar Veseli.

Limaj: Kapiten, djemtë e Kosovës po na bëjnë krenarë me lojëra dhe rezultate

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në njëvjetorin e vdekjes ka kujtuar legjendën e futbollit dhe ish-kryetarin e FFK-së, Fadil Vokri. Limaj ka thënë se ai ishte një prej futbollistëve më të shquar shqiptarë. Kryetari i Nismës e ka quajtur ikonë Vokrin, duke thënë se vdekja e hershme e tij ishte humbje e madhe për shtetin e Kosovës. "Me paraqitjet e tij në fushat e blerta, Vokri u solli çaste të lumtura qytetarëve tanë dhe u bë burim frymëzimi për sportistët në vitet e '80-ta", ka shkruar Limaj. Si kryetar i FFK-së, Vokri, sipas Limajt, ishte më meritor për pranimin e Kosovës në UEFA dhe FIFA. "Kapiten, në njëvjetorin e shkuarjes tënde në amshim, djemtë e Kosovës po na bëjnë krenar me paraqitjet dhe rezultatet në futboll", ka shkruar Limaj.

SHKURT

Munishi, trajner i Ballkanit

Ish-trajneri i disa skuadrave në Kosovë, Ismet Munishi, është emëruar shef i shtabit teknik në skuadrën e Ballkanit. Munishi ka drejtuar Feronikelin, Besën, Hajvalinë, Vëllaznimin dhe Vushtrrinë, kurse e ka marrë drejtimin e Ballkanit për edicionin 2019/2020 në IPKO Superligë. Skuadra nga Suhareka e siguroi mbijetesën në elitë nën drejtimin e Gani Sejdiut, i cili më pas u largua për faktin se nuk gjeti gjuhë të përbashkët me drejtuesit e klubit.

6 lojtarë vazhdojnë kontratat me Feronikelin

Skuadra e Feronikelit është treguar mjaft aktive në fundjavë duke arritur ta vazhdojë bashkëpunimin me disa lojtarë që e bartën barrën kryesore në edicionin e fundit, përfshirë edhe kapitenin Lapidar Lladrovci. Krahas kapitenit, kontratën e ka vazhduar edhe futbollisti Drilon Lladrovci, sulmuesi Mevlan Zeka, mesfushorët Met Millaku e Albutrint Morina si dhe braziliani Jean Da Silva Carioca.

Drenica 'blindon' edhe gjashtë futbollistë

Skuadra e Drenicës ka vazhduar bashkëpunimin me mbrojtësin shkoderan Arsen Sykaj. Ky i fundit edhe për një edicion tjetër do ta bartë fanellën kuqezi. Talenti Befort Dervishaj e ka vazhduar kontratën edhe për dy vjet të tjera me Drenicën, kurse lojtari i tretë që ka vendosur t'i mbetet besnik skuadrës nga Skenderaj është mesfushori Diar Mustafa.

Kabashi: Ndaj Polonisë tregojmë se fitorja kundër Izraelit nuk ishte e rastësishme

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Përfaqësuesja Kosovës në hendboll është duke u përgatitur për ndeshjen e rëndësishme ndaj Polonisë e cila zhvillohet të mërkurën nga ora 20:00 në Prishtinë.

Hendbollisti i Kosovës, Enis Kabashi, është optimist për sfidën e vështirë me polakët. "Jemi duke u përgatitur. Po ushtrojmë dy herë në ditë dhe ushtrimet po shkojnë shumë mirë. Jemi një grup lojtarësh

që njihemi mirë, jemi shumë vite bashkë. Atmosfera në ekip është shumë e mirë. Kundër Polonisë presim përkrahje të madhe nga publiku, që të jetë lojtari ynë i tetë. Duam t'i tregojmë Evropës që fitorja

kundër Izraelit nuk ishte e rastësishme, por mesazh për të gjitha ekipet mesatare evropiane, se Kosovën nuk do ta mposhtin lehtë, sidomos në shtëpinë tonë", ka deklaruar Kabashi.



Challandesi dhe Rashica: Duam tri pikë ndaj Bullgarisë



Kosova e zhvillon sonte ndeshjen e tretë kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2020", kurse trajneri Bernard Challandes dhe futbollisti Milot Rashica kanë paralajmëruar se "Dardanët" kërkojnë tri pikë ndaj Bullgarisë. Ndeshja e parë në mes këtyre dy ekipeve e zhvilluar më 25 mars në 'Fadil Vokri' kishte përfunduar 1-1

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Trajneri Bernard Challandes ka thënë se Përfaqësuesja e Kosovës ka respekt për Bullgarinë, por se synimi i "Dardanëve" në këtë ndeshje është fitorja. Tekniku zviceran nuk e ka përjashtuar mundësinë që të luajë edhe me tre sulmues në këtë ndeshje. Ndeshja në mes të Bullgarisë dhe Kosovës zhvillohet në "Vasil Levski" nga ora 20:45, kurse është e vlefshme për Grupin A. "Kemi respekt për Bullgarinë, por ne do të luajmë për fitore. Bullgaria ka bërë ndryshime së fundmi, por është ekip i fortë. Ne do të përpiqemi ta bëjmë lojën tonë. Taktika jonë nuk do të ndryshohet. Nuk e ndryshoi lojën dhe t'u them lojtarëve që të mbrohen. Ideja është që të fitojmë duke sulmuar ndoshta me 4-3-3, ose 4-2-3-1", ka thënë Challandes. "Të gjithë jemi të mërzitur që Zeneli është jashtë loje. Duhet

të luajmë edhe për të. Ai duhet të qëndrojë i qetë për disa ditë dhe më pas do t'i bëjnë edhe një herë testet mjekësore dhe do të vendosin nëse duhet të operohet. Klubi do të vendosë se çka është më e mira për të", ka shtuar Challandes.

Ylli i Werder Bremenit, Milot Rashica, që shënoi golin në ndeshjen ndaj Malit të Zi, ka thënë se Kosova si në çdo ndeshje tjetër luan për fitore. "Si në çdo ndeshje, edhe në këtë ndeshje do të tentojmë t'i fitojmë tri pikë. Atmosfera është e mirë. Do të ishte edhe më e mirë nëse do të kishim fituar ndeshjen e kaluar. Jemi të përqendruar dhe do ta japim maksimumin për t'i fituar tri pikë", ka thënë Rashica. Për ndeshjen që zhvillohet sonte foli edhe trajneri i bullgarëve, Krassimir Balakov. Ai ka thënë se Bullgarisë i duhet fitoja nëse dëshiron t'i ruajë gjasat për kualifikim në Kampionatin Evropian. "Do të jetë një ndeshje tejet e vështirë, por ne kemi

nevojë ta fitojmë atë nëse duam të kemi ende gjasat për kualifikim. Kosova nuk i frikësohet askujt. Unë e njoh trajnerin e tyre mjaft mirë", ka thënë Balakov.

GRUPI A
20:45 Bulgaria - Kosova
20:45 Republika e Çekisë - Mali i Zi
GRUPI B
20:45 Serbia - Lituania
20:45 Ukraina - Luksemburg
GRUPI D
20:45 Danimarkë - Gjeorgjia
20:45 Irlanda - Gjibraltari
GRUPI F
20:45 Ishujt Faroe - Norvegjia
20:45 Malta - Romania
20:45 Spanja - Suedia
GRUPI G
20:45 Maqedonia Veriore - Austria
20:45 Latvia - Sllovenia
20:45 Polonia - Izrael

Nadali dhe Barty triumfojnë në 'Roland Garros'

PARIS, 9 QERSHOR - Rafa Nadal ka mundur Dominic Thiem në finalen e "Roland Garros" dhe është bërë tenisti i parë që fiton 12 tituj në një Grand Slam. Ka qenë një përsëritje e finales së vitit të kaluar, por këtë herë spanjollit i është dashur një set më shumë për ta mposhtur austriakun. Rafa ka fituar pa shumë probleme setin e parë, i mbyllur 6-3, por Thiem ka reaguuar në të dytin, duke arritur ta fitojë me rezultatin 7-5 dhe

duke krijuar idenë se do të ishte një finale e luftuar në setet pasardhës, por nuk ka qenë kështu. Nadali, në fakt, ka qenë i papërmbajtshëm dhe i pamëshirshëm, duke fituar setin e tretë dhe të katërt me shifrat 6-1. Tenistja australiane Ashleigh Barty është "mbretëresha" e grand slamit të 'Roland Garros'. Numri 8 në botë mundi në finale çeken Marketa Vondrousova (vendi 97 në botë) me rezultatin 2-0 (6-



1, 6-3), duke triumfuar për herë të parë në karrierën e saj në një turne të madh.

SHKURT

Atletico e ka seriozisht ofertën për Hysajn

Skuadra e Atletico Madridit ka bërë një ofertë zyrtare për Elseid Hysajn, e cila është në vlerë prej 25 milionë eurosh. Lajmi është konfirmuar nga "Corriere dello Sport". Mirëpo skuadra aktuale e Hysajt, Napoli, kërkon 30 milionë euro për mbrojtësin shqiptar. Transferimi i Hysajt në La Liga duket i mundshëm, pasi ai nuk e ka vendin e sigurt në formacionin bazë të Napoli, kurse në anën tjetër trajneri Diego Simeone e dëshiron me çdo kusht.

Adolfo Sormani, trajner i Partizanit

Pas largimit të trajnerit Skënder Gega nga Partizani, kjo e fundit e ka zgjedhur trajner të ri italianin, Adolfo Sormani. "FK Partizani në Tiranë ju njofton që ka arritur marrëveshje me trajnerin Italian Adolfo Sormani që ishte pjesë e të kuqeve edhe në vitin 2016-17. Kjo ishte kërkesa e presidentit Gazmend Demit për ta ulur përsëri në stol italianin Sormani, i cili pritet të prezantohet këtë javë dhe më pas t'i zhvillojë përgatitjet për kupat e Evropës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Partizanit.

Liverpooli, me superofertë për De Lightin

Liverpoolit do t'i duhet që Matthijs de Light ta kthejë në lojtarin më të paguar nëse dëshiron ta ketë pjesë të ekipit dhe si pasojë do të duhet që të rriten pagat e Virgil van Dijk dhe Mohamed Salah. 19-vjeçari është tepër i kërkuar nga Manchester City, Manchester United, PSG, Barcelona dhe Bayern Munich. Sipas agjentit të tij, Mino Raiola, një lëvizje në "Anfield" do të ishte mundësi tepër e mirë për Matthijs de Light.

Griezmanni larg Barcelonës, afër PSG-së

Sulmuesi i Francës, Antoine Griezmann, ka konfirmuar largimin nga Atletico Madridi. Ishte pritur që francezi të kalojë në Barcelonë, prestigjiozja "Sport" raporton se sulmuesi mund të kalojë te PSG-ja në Francë. Klubi francez ka shprehur prej kohësh dëshirën që ta ketë në radhët e veta Griezmannin, por paraprakisht duhet ta sakrifikojë njërin nga sulmuesit aktualë: Neymarin, Cavanin, Mbappen.

Cassano rikthehet te Sampdoria

Sampdoria pritet të ketë shumë ndryshime gjatë verës, kurse lajmi më i bujshëm është rikthimi i Antonio Cassanos. Një rikthim për Cassano te skuadra e Sampdoria, këtë herë si drejtues (konsulent i transferimeve), ekip ku ka kaluar çastet më të bukura të karrierës së tij sportive. Ky do të jetë kapitulli i tretë i Cassano me Sampdoria, që si lojtar ka luajtur fillimisht në sezonet 2008-2011 dhe më pas 2015-2017.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Universitetski Klinicki Centar Kosova -
 University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Nr.Ref. 1525/19, datë 06.06.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës, nenit 13 pika 1 e Statutit të QKUK-së, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit të Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës nr. 1060/3 të datës 05.06.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M

Për Anulim të Konkursit publik,

- I. **Anulohet në tërësi** Konkursi publik nr. 1060, datë 14.05.2019 për **Zyrtarë të Teknologjisë Informativë**, dy pozita në QKUK;
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Përzgjedhës i caktuar sipas Vendimit nr. 1060/2 datë 17.05.2019, me Rekomandimin nr. 1060/3 datë 05.06.2019, njofton që ky konkurs të anulohet në tërësi për arsye se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm sipas nenit 6 pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, komisioni kërkon anulimin e tij, të modifikohet më mirë dhe i njëjti të publikohet sa më parë që të jetë i mundur.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe kërkesës në fjalë, lejon anulimin e Konkursit publik për Zyrtarë të Teknologjisë Informativë (dy pozita në QKUK) të modifikohet më mirë dhe i njëjti do të publikohet sa më parë që të jetë i mundur.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET

- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Universitetski Klinicki Centar Kosova -
 University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Nr.Ref. 1525/19, data 06.06.2019.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, članom 13 tačka 1 Statuta UKCK, članom 6 tačka 5.1, Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Postupaka Konkursa u javnom sektoru, i Preporuka predsednik Komisije za izbor br. 1060/3 na dan 05.06.2019. godine, Generalni Direktor UBKSK-a izdao je sledeće:

O D L U K A

Za poništenje (anulira) javnog konkursa

- I. Ukinut u punom javnom konkursu br. 1060, od 14.05.2019.godine za **Službenici za informativne tehnologije dve pozicije u UKCK**;
- II. Sektor kadrova je obavezan da primeni ovu Odluku;
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o ŝ e n j e

Komisija za izbor dodeljena odlukom br. 1060/2 od 17.05.2019, sa Preporukom br. 1060/3 od 05.06.2019. Godine, izveštava da se ovaj konkurs treba u potpunosti poništiti jer nema dovoljno kandidata prema člana 6 tačka 5.1 Administrativnog Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupka javnog konkursa, Komisija traži njeno poništenje, bolje modifikovana i objavljena što je prije moguće.

Shodno tome, Generalni Direktor UBKSK, prema nadležnostima, prema važećem zakonu i preporuke komisije, dozvoljava poništenje javnog konkursa, i zahtijeva bolje modifikovana i objavljena što je prije moguće.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI

- * Kancelarija za kadrove,
- * Informativni medij.
- * Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Abrrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile

Në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor për zgjedhjen e anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, Kuvendi shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

1 (një) anëtar/e, përfaqësues nga shoqëria civile.

I. Kandidati për anëtar në Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë;
3. Të ketë njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut;
4. Të ketë përvojë pune në çështjet ligjore së paku 5 (pesë) vjet;
5. Të ketë përkrahjen e së paku 5 (pesë) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë;
6. Të mos jetë i dënuar për vepër penale.

II. Shoqëria civile duhet t'i bashkëngjisë listës së kandidatëve të nominuar për anëtar edhe dokumentet, të cilat vërtetojnë se kandidati i plotëson kushtet e paraqitura në këtë shpallje publike.

III. Kuvendi i Kosovës inkurajon shoqërinë civile, që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtar të KPK-së, të marrë parasysh përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar të barazisë gjinore.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum Vitae);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës (duke bashkëngjitur edhe raportin nga Trusti pensional);
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **24 qershor 2019, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217);

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: (0) 38 211-182, 211-181 dhe (0) 44 567 - 041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor jednog (1) člana Tužilačkog saveta Kosova, predstavnik civilnog društva

Na osnovu člana 9 i 10 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova i u cilju ispunjavanja zakonske obaveze za izbor člana nezavisnog veća Kosova, Skupština raspisuje konkurs za popunjavanje položaja:

Jedan (1) član/ica, predstavnik civilnog društva.

II. Kandidat za člana Tužilačkog saveta Republike Kosova, dužan je da ispuni sledeće uslove:

1. Da je državljanin i stanovnik Republike Kosova;
2. Da poseduje visoku stručnu spremu iz oblasti prava;
3. Da poseduje znanje iz oblasti ljudskih prava;
4. Radno iskustvo o pravnim pitanjima, najmanje pet (5) godina;
5. Da uživa podršku najmanje pet (5) organizacija civilnog društva iz oblasti prava;
6. Da nije kažnjavan za krivično delo;

II. Civilno društvo dužno je da priloži listi nominiranih kandidata za člana i dokumente, koji dokazuju da kandidat ispunjava uslove ovog javnog konkursa.

III. Skupština Kosovo ohrabruje civilno društvo da tokom dostavljanja predloga za člana TSK, uzme u obzir više-etnički sastav Republike Kosova i priznata načela o polnoj ravnopravnosti.

Aplikaciji priložiti prateće dokumente:

- Autobiografija (Curriculum Vitae);
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi (diplome Univerziteta van zemlje, moraju biti nostrifikovane od strane Ministarstva za obrazovanje, nauku i tehnologiju);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu (prilaže i izveštaj od Trusta penzijske štednje);
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo;

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do **24.06.2019. god., u 16:00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili poštom, na adresu:

Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (ul. "Majke Tereze" b.b., Direkcija osoblja, kancelarija br. N-217).

Aplikacije se mogu preuzeti:

Štampani obrazac: na recepciji zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majke Tereze" b.b., ili

Elektronski obrazac: veb-stranica Skupštine Republike Kosova-
www.assembly-kosova.org

Ostale dodatne informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16:00 časova, na brojeve telefona: (0) 38- 211-182, 211 - 181 i (0) 44 567 041.

Aplikacija se mora dostaviti sa traženim dokumentima.

Korišćenje pogrešno popunjene i nekompletne aplikacije sa potrebnim podacima i podacima predstavljanim sa zakašnjenjem, smatraće se nevažećim.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerzitetske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova University
 Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit të 4 Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; Nenit 6 pika 1.1 dhe nenit 13 pika 1 dhe 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës, (SHSKUK), nenit 12, paragrafi 6 pika 6.12 e Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; Nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; Nenit 5 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003 datë 21.07.2016 dhe Imelit të datës 29.05.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së shpallë:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

- Embriolog për Laboratorin në Klinikën Obstetrike dhe Gjinekologjisë (2 pozita)

I. Koefficienti i pagës: 8.4
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raportoni: Drejtorit të Klinikës Obstetrike dhe Gjinekologjisë në QKUK
Nr. i Referencës: QKUK – 26/2019-06/2

Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka.

Përgjegjësit kryesorë të Embriologut:

- Është pjesë e ekipit për fertilizim të asistuar,
- Së bashku me profesionistët tjerë, merr pjesë në konsulta pre-konceptonit të çiftëve,
- Bën vlerësimin dhe pregatit gameteve mashkullore për fekondim,
- Bën vlerësimin dhe pregatitë gametet femërore për fekondim,
- Përcakton kualitetin e gameteve të aspiruara/marra,
- Bën fertilizimin e gameteve femërore me ato mashkullore duke përdorur ICSI metodat kur është e nevojshme,
- Mbikqyrë embrionet gjatë zhvillimit të hershëm të tyre,
- Ndhmon pjesën tjetër të ekipit në transferimin e embrionit tek nëna.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit:

- Mjek i diplomuar me Specializim në sferën e embriologjisë humane; ose
- Biolog i diplomuar me specializim në embriologji humane;
- Licence e embriologjisë humane;
- Njohja e gjuhës angleze e domosdoshme - dëshmi;
- Përvoja e punës në fushën e embriologjisë humane se paku një vjet;
- Letërnjoftimi fotokopje, dhe
- Certifikata e lindjes, fotokopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë, shtetas të Republikës së Kosovës.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kushtet e konkursit.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në shtet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit të QKUK-së, ndërtesa e re e Administratës ose me Telefon nr. 038/512-667.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit. Nuk do të pranohen aplikacione ndryshe nga dëshmitë që kërkohen më këtë konkurs.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas këtij konkursi, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova (UBKSK) - Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Univerzitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
 Kadrovska Sluzba

Prema članu 8, tačka 1 i 2, Zakona o radu br. 03/L-212, člana 4, Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, člana 6. tačka 1.1 i član 13 tačka 1 i 3. Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), člana 12 tačka 6 (6.12) Statuta Kliničkog Univerzitetski Centr Kosova; kao i član 62, stav 6, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo; Član 5, Uredbe o Radnim Odnosima br. 1003 datum 21.07.2016; i e-mailila dana 29.05.2019, Generalni Direktor UBKSK, raspisuje:

KONKURS

Institucije: Univerzitetski Bolničke i Kliniçe Sluzbe Kosova. (UBKSK)
 Univerzitetski Klinički Centar Kosova (UKCK)

- Embriolog za Laboratoriju Akušerske i Ginckološke Klinike (2 pozicije)

Koefficient zarade: 8.40,
Radna Vreme: Puno radno vreme,
Ugovor: ,
Izveštaj: Direktor Akušerske i Ginckološke Klinike u UKCK.
Referentni br. UKCK - 26/2019-06/2

I. Osnovna svrha posla:

Pružanje zdravstvenih usluga u pogledu kvaliteta i kvantiteta zasnovane na profesionalnom nivou koj je ima.

Ključne odgovornosti lekara specijalista:

- Treba da bude deo tima za podršku oplodnje,
- Zajedno sa drugim profesionalcima, učestvuje u konsultovanju pred-koncepta parova,
- Ocenjuje i priprema muške gamete za oplodnju,
- Procenjuje i priprema ženske gamete za oplodnju,
- Određuje kvalitet usisanih / dobijenih gameta,
- Čini oplodnju ženskih i muških gameta upotrebom ICSI metoda kada je to potrebno,
- Nadgledati embrione tokom njihovog ranog razvoja,
- Pomaže ostatku tima u transferu embriona majci.

Obrazovanje je potrebno: Da ima univerzitetsku diplomu iz oblasti na osnovu specifičnosti institucije

- Diplomirani doktor sa specijalizacijom iz oblasti humane embriologije; ili
- Diplomirani biolog sa specijalizacijom iz humane embriologije;
- Licenca (dozvola) za humane embriologiju;
- Poznavanje potrebnog engleskog jezika - dokaza;
- Iskustvo u oblasti humane embriologije najmanje godinu dana;

* Lična karta fotokopija, i

* Izvod matične knjige rođenih, fotokopija.

Uslovi učeća u zapošljavanju: pravo da se konuriše imaju svi građani Republike Kosova, odraslih koji imaju punu pravnu sposobnost, su završili svoje obrazovanje.

Uslovi radova konkursa: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Datum zatvaranja konkursa: **15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.**

Podnošenje konkursa: Aplikacija se uzimaju i dostavlja - Sektor kadrovski UKCK, u novoj Administrativne Zgrade ili telefonom br. 038/512-667.

U Aplikaciji treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Sva dokumenta i dokaz profesionalno da se pridruži aplikaciju.

Podnete aplikacije po isteku roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Kandidati pruži dokaze pod objavljivanjem konkursa, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju.

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu

Sot u bënë një vit pa nënën dhe gjyshen tonë të dashur

Bahtije Koca

(28.05.1935-10.06.2018)

Kaloi një vit, por nuk u shua dhimbja dhe kujtimi për ty, nënë dhe gjyshe jonë e dashur. Nuk kalon as një ditë pa të kujtuar dhe pa të përmendur, ty që ishe shembull i një gruaje dhe që bëre aq shumë për familjen tonë. Kujtimi për ty gjithmonë do të jetë pjesë e jetës tonë.

E përkujtojnë me mall djemtë: Asllani, Ismeti, Fadili dhe Fatmiri. Vajzat: Rifadija dhe Remzija. Nipat: Arbeni, Lulezimi, Muhameti, Betimi, Perparimi, Sheremeti, Shqipdoni, Rinori dhe Drenisi. Mbesat: Lavidija, Fitorja, Shqiponja dhe Brendona.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Idriz Sinani shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës Teknike drejtimi Elektricitist reparti në Mitrovicë.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy balkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy balkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përballë Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel: 044/641-524 dhe + 46705793508.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Shefqet Shala, B.I.-Skenderaj. Tel.044-499-713.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Hasan Osmani, B.I.-Skenderaj. Tel. 044-355-579.

► Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Ensari - Bujk, Drenas. Tel. 049-250-828.

► Lëshoj me qira lokal in përballë spitaleve në Ulpianë në Prishtinë, D8 me 50m2 i përshtatshëm për ordinancë, barnatore, laborator etj. Për më shumë indor në tel: 044-312-215.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet mbi "Kurritz" në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Hyrja e 7 kati i 9. Banesa ka 45 metra katror me inventar. Banesa lëshohet prej 01.08.2015 çmimi 200 euro pa ndërmjetësues. Numri kontaktues: 044 672 439



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales